



ProCredit Bank
Kosovo

Raportu vjetor 2020



Përmbajtja:

1. Misioni i Bankës
2. Etika e biznesit
 - 2.1 Transparenca
 - 2.2 Kultura e komunikimit të hapur
 - 2.3 Përgjegjësia dhe toleranca shoqërore
 - 2.4 Standardet e larta profesionale
 - 2.5 Integriteti dhe përkushtimi personal
 - 2.6 Politikat mjedisore të Bankës
3. Informatat themelore të Bankës ProCredit
 - 3.1 Struktura aksionare
4. Segmentet kryesore të biznesi
 - 4.1 Klientët e Biznesit
 - 4.2 Klientët privatë
 - 4.3 Bankimi Direkt
5. Menaxhimi i rrezikut
 - 5.1 Menaxhimi i rrezikut kreditor
 - 5.2 Menaxhimi i rrezikut të ekspozimit ndaj palëve të tjera
 - 5.3 Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit dhe financimit
 - 5.4 Menaxhimi i rrezikut valutor
 - 5.5 Menaxhimi i rrezikut të normës së interest
 - 5.6 Menaxhimi i mjaftueshmërisë së kapitalit
 - 5.7 Menaxhimi i rrezikut operacional dhe të mashtrimit
 - 5.8 Parandalimi i pastrimit të parave
6. Zhvillimi i stafit
7. Pasqyrat financiare

Misioni i Bankës

Banka ProCredit është bankë komerciale e orientuar nga zhvillimi. Ne ofrojmë shërbime cilësore për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, si edhe për klientët privatë që kanë kapacitet për të kursyer dhe preferojnë të bankojnë përmes kanaleve elektronike. Në operacionet tona ne u përmbahemi disa parimeve bazë: vlerësojmë transparencën gjatë komunikimit me klientët tanë, nuk promovojmë kredi konsumuese, jemi të përkushtuar ndaj zvogëlimit të ndotjes së mjedisit, si dhe ofrojmë shërbime të bazuara në gjendjen e çdo klienti dhe në analizën e shëndoshë financiare.

Fokusi ynë është ofrimi i shërbimeve për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, sepse jemi të bindur që këto biznese krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës dhe japin kontribut thelbësor në ekonomitë ku veprojnë. Duke ofruar shërbime të thjeshta depozituese, shërbime bankare online, si dhe duke investuar burime të konsiderueshme në edukimin financiar, ne synojmë të promovojmë kulturën e kursimit dhe përgjegjësinë financiare tek klientët e biznesit dhe klientët privatë. Aksionarët tanë presin fitim të qëndrueshëm nga investimet afatgjata dhe nuk janë të interesuar për maksimizimin e fitimit në afat të shkurtër. Ne bëjmë investime të mëdha në trajnimin e personelit, që të krijojmë atmosferë të kënaqshme dhe efikase të punës, si dhe të ofrojmë shërbime profesionale dhe të përshtatshme për klientët tanë.



Etika e biznesit

Pjesë e misionit të përgjithshëm të Grupit ProCredit është vendosja e standardeve në sektorët financiarë ku ne operojmë. Ne duam që të bëjmë ndryshimin nëpërmjet: grupeve të synuara të cilave u shërbejmë, cilësisë së shërbimeve tona financiare dhe etikës së biznesit. Operacionet e Grupit ProCredit udhëhiqen nga këto parime:

Transparenca: Ne ofrojmë informata transparente për klientët tanë, opinionin publik dhe punonjësit tanë. Për shembull, ne sigurohemi që klientët t'i kuptojnë tërësisht kushtet e kontratave që ata lidhin me ne dhe angazhohemi në edukimin financiar të tyre, me qëllim që të rrisim vetëdijësimin e publikut nga rreziqet e ofertave financiare jotransparente.

Kultura e komunikimit të hapur: Ne komunikojmë me njëri-tjetrin haptas, në mënyrë të drejtë dhe konstruktive. Konfliktet në punë i trajtojmë në mënyrë profesionale, duke punuar bashkërisht për të gjetur zgjidhje.

Përgjegjësia dhe toleranca shoqërore: Ne ofrojmë këshilla të shëndosha dhe me bazë të sigurt për klientët tanë. Para se të ofrojmë kredi për klientët tanë, ne vlerësojmë gjendjen e tyre ekonomike dhe financiare, potencialin e biznesit të tyre dhe kapacitetin e tyre për kthimin e kredisë, në mënyrë që të shmanget mbiborxhi dhe që të ofrojmë shërbime të përshtatshme financiare. Për më tepër, ne jemi të përkushtuar në trajtimin e të gjithë klientëve dhe punonjësve me korrektësi dhe respekt, pa marrë parasysh origjinën, racën, gjuhën, gjininë apo besimet e tyre fetare. Ne gjithashtu sigurohemi që kërkesat e aplikuesve për financim të vlerësohen në aspektin e përputhshmërisë me praktikën tonë të etikës së biznesit. Nuk është lëshuar asnjë kredi për individë ose biznese në qoftë se ka patur dyshime se përdorin metoda të punës të pasigurta, të dëmshme për mjedisin apo moralisht të papranueshme, e veçanërisht nëse shfrytëzojnë fëmijët për punë.

Standardet e larta profesionale: Punonjësit tanë marrin personalisht përgjegjësi për cilësinë e punës së tyre dhe gjithmonë bëjnë përpjekje t'u zhvilluar profesionalisht.

Integriteti dhe përkushtimi personal: Nga të gjithë punonjësit e Grupit ProCredit kërkohet në çdo kohë sinqeritet i plotë dhe çdo mosrespektim i këtij parimi trajtohet shpejt dhe në mënyrë rigoroze. Këto parime përfaqësojnë shtyllën kryesore të kulturës sonë korporative dhe zbatohen në mënyrë aktive në operacionet tona të përditshme. Ato pasqyrohen në Kodin e Mirësjelljes së ProCredit-it, që i përkthen parimet e Grupit në udhëzime praktike për personelin tonë.

Politikat mjedisore të Bankës

ProCredit Bank është bankë me orientim zhvillimor, që kryen veprimtari bankare të përgjegjshme. Pjesë e kësaj përgjegjësie është të vepruarit në pajtueshmëri me standardet e parapërcaktuara shoqërore, etike dhe mjedisore.

Qasja e përgjegjshme ndaj mbrojtjes së mjedisit është pjesë e rëndësishme e modelit të përgjegjshëm biznesor e shoqëror të Bankës ProCredit dhe vlerë e integruar në filozofinë tonë bankare.

Marrja e masave për uljen e ndotjes së mjedisit, përballë ndryshimeve aktuale klimatike, është çështje që kërkon trajtim urgjent. Prandaj, mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi e secilit prej nesh, pavarësisht profilit të veprimtarisë sonë. Në këtë kontekst, Banka ProCredit, nëpërmjet Komitetit Mjedisor, është e përkushtuar ndaj zbatimit të politikave që avancojnë qasjen e Bankës ndaj menaxhimit të ndikimit në mjedis të vetë institucionit dhe të klientëve të vet.

Standardet mjedisore të Bankës ProCredit kanë për qëllim: uljen e ndikimit në mjedis të aktiviteteve tona; integrimin dhe zbatimin e procedurave miqësore ndaj mjedisit në një sistem gjithëpërfshirës operacional; ndikimin e drejtpërdrejtë të bankës në kursimin e energjisë, si edhe zvogëlimin e nivelit të dioksidit të karbonit që çlirohet etj. Banka ProCredit në Kosovë vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në rritjen e vetëdijësisë mjedisore të punonjësve të vet, klientëve dhe publikut të gjerë, si dhe në përkrahjen e nismave qytetare për ruajtjen e mjedisit etj.

**Menaxhmenti****Eriola Bibolli**

Drejtoreshë Gjenerale e ProCredit Bank në Kosovë

Bejtë Cakaj


Anëtar i Bordit Menaxhues të ProCredit Bank në Kosovë

Visar Paçarada

Anëtar i Bordit Menaxhues të ProCredit Bank në Kosovë

Informatat themelore të Bankës ProCredit

Struktura aksionare



Struktura aksionare

Sipas njoftimeve për të drejtat e votës, në fund të vitit përfaqësohet 55% e aksioneve në ProCredit Holding u përkisnin aksionarëve kryesorë: Zeitnger Invest GmbH, Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), DEON Participaties BV dhe International Finance Corporation (Korporata Financiare Ndërkombëtare, pjesë e Grupit të Bankës Botërore). Edhe ProCredit Staff Invest Beteiligungs GmbH është aksionar kryesor, me përfaqësimin 3% të aksioneve.

The Teachers Insurance and Annuity Association of America zotëron ndërmjet 5% dhe 10% të aksioneve. Më 31 dhjetor 2020, pjesa e aksioneve me ofertë publike, e përcaktuar si zotërime më pak sesa pragu prej 5% i të drejtave të votës, ishte afërsisht 39%, sipas njoftimeve për të drejtat e votës. Kjo përfshin investime prej më shumë se 3% në ProCredit Holding AG&Co. KgaA nga FMO (Netherlands Development Finance Company – Kompania Financiare e Zhvillimit në Holandë), BIO (Kompania e Belge e Investimit për Vendet në Zhvillim), Fondacioni i Mikrofinancës Omidyar-Tufts, Fondi Menaxhimit MultiConcept, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe MainFirst.

FitchRatings
BB

ProCredit është e vetmja bankë në Kosovë e vlerësuar nga agjencia ndërkombëtare e vlerësimit Fitch Ratings.

Supervised by
BaFin



Ne punojmë sipas praktikave më të mira të bankut dhe standardeve rregullatore në Gjermani, një sistem bankar që është vërtetuar se është më i qëndrueshmi në Evropë. Bankat ProCredit të konsoliduara janë nën mbikëqyrjen e BaFin – Autoriteti Federal Gjerman për Mbikëqyrjen Financiare.

Segmentet kryesore të biznesit



Klientët e Biznesit

Fokusi i bankës sonë mbetet të qenurit bankë “hausbank” për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe ofrimi i shërbimeve për këto ndërmarrje, sepse jemi të bindur që këto ndërmarrje krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës dhe japin kontribut thelbësor për ekonominë ku operojnë. Qasja e bankës për t’i menaxhuar marrëdhëniet me klientët biznes dhe profesionalizmi i këshilltarëve të biznesit të bankës, kanë bërë që banka t’i kuptojë nevojat e klientëve edhe në këtë vit sfidues të ballafaqimit me COVID-19, duke vazhduar t’i përkrahë bizneset e tyre dhe kapacitetin financiar që kanë, duke u mundësuar shërbime financiare të përshtatshme dhe financim efektiv dhe efikas. Banka vë theks të posaçëm tek shërbimet financiare të përgjegjshme.

Në përputhje me strategjinë e Grupit, banka ka zhvilluar për klientët e vet konceptin e biznesit “hausbank”, pra banka jo vetëm që financon kredi dhe produkte të tjera financiare për klientët biznes, por edhe ofron një gamë të gjerë të shërbi

meve financiare moderne që u nevojiten ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për t’u zgjeruar. Këto shërbime përfshijnë: platformën e avancuar elektronike e-banking, përmes së cilës klientët biznes mund të kryejnë transfertat kombëtare dhe ndërkombëtare në mënyrë të shpejtë dhe të sigurtë dhe me kosto të ulëta; pagesa të pagave dhe masive; pagesa të faturave; pagesa për Doganën; menaxhim të llogarisë së kredisë dhe linjës kreditore; kartela dhe transaksione efikase në терминаlet POS; shërbime të financave tregtare; dhe modelin digjital të bankimit në Zona 24/7. Këto hapësira mundësojnë që bizneset të bëjnë tërheqjen e mjeteve 24 orë në 7 ditë të javës, depozitim të realizmeve ditore në ATM Cash In në vlera deri në EUR 10,000 si dhe depozitim në shumë më të larta në kutitë bankare.

Shërbimet tona bankare i ndihmojnë biznesit të zgjerohet dhe të veprojë në mënyrë më efikase. Ato sjellin qëndrueshmëri për bizneset. Banka ka qëllim të ketë partneritet afatgjatë me ndërmarrjet

e vogla dhe të mesme dhe ta përcjellë zhvillimin e tyre. Këto elemente, të kombinuara me përvojën e specializuar të këshilltarëve të biznesit, janë baza e modelit tonë për biznes të suksesshëm.

Ne kemi vazhduar ta vëmë theksin e veçantë tek promovimi i shërbi-meve të tjera bankare që përputhen me nevojat e klientëve tanë. Për t'i plotësuar nevojat e klientëve biznes, gjatë tërë vitit kemi punuar në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve në kanalet tona digjitale me qëllim që të vazhdojmë të ofrojmë bankim inovativ, të shpejtë dhe të sigurt. Përveç Zonave 24/7 ku janë vendosur pajisje të teknologjisë së lartë që ofrojnë fleksibilitet dhe efikasitet të lartë për klientët biznes, pa pasur nevojë të kufizohen nga orari i punës së bankës, klientët mund të depozitojnë shuma më të mëdha në kasafortën bankare, si dhe të depozitojnë monedha në ATM të veçantë. Po ashtu, banka ka përshtatur dhe ka avancuar platformën e e-banking në përputhje me nevojat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe me zhvillimet e fundit teknologjike. Banka ka promovuar dhe avancuar me theks të veçantë shërbimin e-commerce, platformë që u mundëson klientëve biznes shitjen online, në linjë me nevojat e tyre dhe zhvillimet në tregun ndërkombëtar.

Viti 2020, për shkak të ballafaqimit me pandeminë, ka qenë vit sfidues për bizneset e vogla dhe të mesme. Banka ka vazhduar financimin e bizneseve dhe përkrahjen e tyre edhe në këtë kohë, jo vetëm përmes financimit, por edhe përmes dhënies së këshillave të duhura për të menaxhuar sa më mirë sfidat këtë vit. Banka i ka dhënë fokus të veçantë stimulimit dhe promovimit të kredive investive për të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sidomos për ato prodhuese, duke arritur kështu pjesëmarrjen më të lartë në treg për kreditë në sektorin e prodhimit.

Rritja e portofolit të bizneseve gjatë vitit 2020 ishte mbi EUR 12 milionë. Volumi total i ekspozimeve kreditore dedikuar bizneseve në fund të vitit 2020 arriti afër vlerën EUR 425 milionë.

Banka ProCredit, si bankë që zhvillon veprimtari të përgjegjshme bankare, ka fokus të veçantë tek të vepruarit në pajtueshmëri me standardet mjedisore. Banka ka vazhduar t'i mbështesë klientët e vet të cilët kanë investuar përmes "kredive të gjelbra", term ky që i karakterizon të gjitha shërbimet financiare për investim në kursim të energjisë, në burime të energjisë së ripërtëritshme, si dhe masa tjera miqësore ndaj mjedisit. Gjatë vitit 2020, ka vazhduar qëllimi që të stimulohen sa më shumë klientët biznes që të ndërmarrin investime të tilla, me fokus të veçantë në kursimin e energjisë elektrike nëpërmjet investimeve në

panele diellore, në avancim të makinerive prodhuese dhe në masa që do të ulnin ndotjen e ujit apo të ajrit. Portofoli i kredive të gjelbra për klientët biznes përfaqëson 18% në total portofolin e kredive.

Banka ProCredit ka ofruar llogari kursimi për klientët e vet biznese, duke mundësuar kështu transferimin e likuiditetit shtesë të biznesit të tyre në llogari me interes dhe fleksibilitet në përdorimin e saj. Volumi i depozitave të klientëve biznes këtë vit ka arritur mbi EUR 167 milionë, duke arritur kështu një rritje vjetore të depozitave mbi 30 milionë euro.

Këtë vit, banka ka caktuar një ekip të veçantë të këshilltarëve të biznesit të cilët kanë fokus menaxhimin dhe përvetësimin e klientëve shumë të vegjël, me qëllim që kështu të përkrahë rritjen dhe zhvillimin e bizneseve shumë të vogla. Fondet garantuese lokale dhe ndërkombëtare që banka ka përfituar duke patur parasysh pozicionimin në treg, i dedikon pikërisht tek kjo pjesë e bizneseve shumë të vogla dhe të vogla, në mënyrë që të ndikojë tek zhvillim ekonomik i vendit në përgjithësi dhe tek punësim në veçanti.

Banka i konsideron këshilltarët e klientëve biznes si pikë kyçe në zbatimin e strategjisë së bankës për zhvillimin e marrëdhënieve profesionale afatgjata me klientët biznes. Këshilltarët e biznesit janë kanali kryesor jo vetëm për ofrimin e shërbimeve bankare për klientët biznes, por edhe për këshillim dhe diskutime profesionale me klientët e vegjël dhe të mesëm të bankës. Banka në vazhdimësi investon në trajnimin dhe zhvillimin profesional të këshilltarëve të biznesit.

Banka do të vazhdojë të përshtasë dhe zhvillojë shërbime bankare në funksion të bizneseve, me qëllim që t'u ndihmojë atyre të zhvillohen dhe të kenë qëndrueshmëri. Gjithashtu, Banka konsideron që të ofrojë shërbime të njëjta edhe për klientët të tjerë biznesi. Përveç përkrahjes së investimeve afatshkurtra dhe afatmesme të bizneseve, fokusi ynë i veçantë për vitin 2021 do të vazhdojë të jetë në përkrahjen dhe stimulimin e investimeve afatgjata, e në veçanti në përkrahjen e bizneseve prodhuese dhe stimulimin e investimeve eko. Banka do të vazhdojë të ofrojë platformën e-banking, me qëllim të ofrimit të mënyrave më efektive të të bërit biznes nga ana e klientëve të vet. Poashtu, banka do të vazhdojë të përkrahë bizneset në kanalizim të shtijeve të tyre në pikat e shitjes POS dhe përmes platformës së pagesave online, e-commerce. Synim i bankës tonë mbetet të qenurit "hausbank" për klientët e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe krijimi i bashkëpunimeve afatgjata me këta klientë.



Klientët privatë

Në vitin 2020, Banka ProCredit arriti të vërë plotësisht në zbatim dhe të pozicionohet tërësisht si bankë direkte - digjitale sa i përket shërbimit ndaj klientëve privatë. Për ta theksuar edhe më tej këtë pozicionim, banka ka vazhduar të investojë në platformat e veta digjitale që u mundësojnë klientëve qasje të lehtë dhe të përshtatshme në financat e tyre.

Përgjatë vitit 2020, Banka ProCredit ka përditësuar në vazhdimësi aplikacionin mobil që ka për qëllim t'ju mundësojë klientëve realizimin e transaksioneve financiare përmes telefonit të tyre nga rehatia e shtëpisë, zyrës apo kudo që gjenden. Për më tepër, aplikacioni mobil ka bërë të mundur që klientëve t'u krijohet hapësirë për menaxhim të lehtë të kursimeve të tyre dhe të limiteve të kartelave, të realizojnë pagesa të ndryshme brenda bankës dhe brenda bankave kombëtare, si edhe pagesat utilitare. Përmes uebfaqes i është dhënë fokus procesit të aplikimit për llogari dhe për financim, proces i cili në masë të madhe ka kaluar përmes platformave online, me qëllim që klientët të mos e kenë të nevojshme

të paraqiten pranë zyrave të Bankës, por këtë proces ta realizojnë nga komoditeti i zyrave apo shtëpive të tyre.

Gjatë vitit 2020, Banka u ka ofruar klientëve qasje të lehtë në instrumente financiare që kanë pasur për qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të banimit. Me përkushtim të vazhdueshëm, Banka ProCredit ka mbështetur planet për investim të klientëve privatë, me fokus të veçantë tek financimi i blerjes apo ndërtimit të shtëpive. Në fund të vitit 2020, banka ka arritur të rrisë pjesëmarrjen e kredive për banim në 61% në krahasim me 54% sa ka qenë në vitin 2019.

Në aspektin e depozitave, qëllimi i Bankës ProCredit është të rrisë edukimin financiar dhe të nxisë kulturën e kursimit tek klientët privatë. Gjatë vitit 2020, depozitat e bankës janë zhvilluar në linjë me planifikimet e biznesit dhe është arritur që të mbahet portofoli me strukturë të diversifikuar mirë. Banka e ka mbyllur vitin 2020 me një total prej EUR 465 milionë.

Bankimi Direkt

Viti 2020 ka shënuar finalizimin e zbatimit të strategjisë së bankës për bankim direkt, strategji kjo që u ofron klientëve një gamë shërbimesh. Krahas zhvillimeve në rrjetin e brendshëm të bankës, përmes strategjisë së bankimit direkt, banka u ka mundësuar klientëve të vet qasje të lehtë në financat e tyre. Mundësia për të hapur llogarinë dhe shërbimet e tjera mbështetëse përmes faqes së internetit të Bankës ProCredit është jashtëzakonisht efikase, e thjeshtë dhe vlerësohet shumë nga klientët, duke patur parasysh që klientëve u është ofruar fleksibilitet për të zgjedhur kohën dhe vendin e tyre të dëshiruar për bankim.

Nëpërmjet Qendrës së Kontaktit, tashmë me një rol të avancuar, Banka është e përkushtuar t'u shërbejë klientëve në kohë të shpejtë dhe me efikasitet, duke i këshilluar rreth shërbimeve financiare dhe platformave digjitale. Në këtë mënyrë, banka sigurohet që të ofrojë shërbim të shpejtë dhe të pavarur për klientët privatë dhe biznes.



Menaxhimi i rrezikut

Menaxhimi i rrezikut kreditor

Thelbi i veprimtarisë afariste të Bankës ProCredit është ofrimi i përkrahjes financiare për klientët e biznesit të vogël dhe të mesëm (NMV-të), si dhe për individët privatë, të cilët prioritet kanë kursimet dhe favorizojnë investimet afatgjata.

Parimet themelore të Bankës për menaxhimin e rrezikut kreditor janë të përcaktuara në Politikën për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor dhe në Politikën për Vlerësimin e Kolateralit, të cilat bazohen në politikat e Grupit ProCredit. Së bashku, këto politika pasqyrojnë përvojën që ka grupi me operacionet e suksesshme të huadhënies në ekonomitë në zhvillim dhe ato në tranzicion. Këto dokumente janë në harmoni të plotë me ligjet dhe rregulloret në Kosovë.

Nëpërmjet analizës intensive të aftësisë kredimarrëse të klientëve tanë, Banka zbaton parime të ndryshme me qëllim që të zvogëlojë rrezikun kreditor. Kjo nënkupton zbatimin e masave për të shmangur mbingarkimin e klientëve me borxhe, monitorimin e rregullt të ekspozimeve kreditore, si dhe menaxhimin e ekspozimeve kreditore me probleme. Për më tepër, zbatimi i proceseve të dizajnuara me kujdes dhe të mirë-dokumentuara, zbatimi i parimit “të katër syve”, ndërtimi i marrëdhënieve afatgjata me klientët dhe ruajtja e kontakteve të rregullta me klientët, si dhe investimi te punonjësit e mirë-trajnuar dhe tepër të motivuar kontribuon në zvogëlimin e rrezikut kreditor. Gjithashtu, Banka zbaton një sistem të mbikëqyrjes së portofolit kreditor që na lejon të identifikojmë dhe të menaxhojmë probleme të mundshme që në fazë të hershme. Për të siguruar eficiencë, sistemi është kalibruar për të pasqyruar Standardin Ndërkombëtar për Raportimin Financiar (IFRS 9). Banka, gjithashtu, vijon të angazhohet në analizimin e tregjeve të sektorëve të ndryshëm ekonomikë.

Për më tepër, rreziku kreditor zvogëlohet nga fakti se portofoli kreditor i Bankës është shumë i diversifikuar dhe çdo përqendrim i mundshëm i rrezikut kreditor vlerësohet plotësisht për të parë ndikimin që mund të ketë në aftësinë e Bankës për ta përballuar atë. Për sa u përket grupeve të klientëve, ky diversifikim i portofolit tonë përfshin ndërmarrjet e mesme, të vogla dhe shumë të vogla, si dhe individët privatë e institucionet. Qasja e ndjekur nga Banka kërkon t’u ofrojë klientëve produkte të thjeshta dhe që kuptohen lehtë.

Duke marrë parasysh faktin se shumica dërrmuese e kredive të Bankës janë të ripagueshme me anë të kësteve mujore, paaftësia e huamarrësit për të respektuar afatin e pagesës trajtohet si shenjë fillestare e mundësisë së mospagimit në kohë dhe nxit menjëherë reagimin e Bankës. Procesi i ri i monitorimit, që bazohet në treguesit e paralajmërimit të hershëm treguesit me shenja të hershme të rrezikut kreditor mundëson Bankës t’i përgjigjet menjëherë çdo shenje të ndonjë mundësie për mospagesë në kohë.

Menaxhimi i rrezikut kreditor përbënte një fokus të qartë përgjatë vitit 2020. Përvoja e gjatë me tregun dhe përzgjedhja e kujdesshme nga banka e klientëve ka përkrahur fuqimisht këtë përpjekje të saj. Nisur nga pandemia COVID-19, Banka ndërmori disa masa për të zvogëluar përkeqësimin e cilësisë së portofolit të huave. Hapi i parë ishte mbajtja e një komunikimi aktiv me të gjithë klientët biznese dhe privatë për të marrë informacion të dejtëpërdrejtë mbi ndikimin e mundshëm në aktivitetet dhe financat e tyre. Kjo mundësoi mbikëqyrjen dhe analizën e rrezikut, duke u fokusuar në ato që u ndikuan më së shumti nga pandemia. Duke u mbështetur në udhëzimet për ristrukturimin e huave për shkak të Covid-19 të dhëna nga Banka Qendrore e Kosovës, banka pati mundësi të përkrahte huamarrësit duke lehtësuar pagesat e atyre që ishin në vështirësi financiare të shkaktuar nga shpërthimi i pandemisë. Këto masa për ristrukturim ishin një mjet i vlefshëm në përgjigje të pasigurisë në pikun e pandemisë.

Në fund të vitit 2020, më pak se 6% e portofolit tonë ishte ende nën moratorium. Pavarësisht shpërthimit të pandemisë, gjatë vitit 2020 treguesit kryesorë të cilësisë së portofolit të huave vijuan të shfaqin një prirje të qëndrueshme, duke pasqyruar për rrjedhojë një cilësi të lartë të portofolit të huave të bankës. Norma e huave me probleme në fund të vitit qëndroi në 3.4%. Mbulimi i portofolit të huave me probleme me provizione për humbjet nga huatë ishte 118%, që konsiderohet nivel i përshtatshëm.

Përsa i përket të ardhmes, rreziku kreditor mbetet në fokus përgjatë 2021 në nivel portofoli dhe nivel individual, duke monitoruar klientët që janë prekur dhe duke i përkrahur ata për të tejkaluar vështirësitë financiare

Menaxhimi i rrezikut të ekspozimit ndaj palëve të tjera

Me qëllim që të menaxhohet rreziku i likuiditetit dhe veprimtaritë e tjera operationale, Banka ProCredit mban një pjesë të aktiveve të saj në investime likuide me palë të tjera të jashtme, ku përfshihen emetuesit e letrave me vlerë. Në këtë rast, banka ekspozohet ndaj rrezikut që këto palë mund të mos jenë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre kundrejt bankës.

Ne e menaxhojmë këtë rrezik në mënyrë aktive duhet përdorur masa të parashikuara në politikat tona të menaxhimit të rrezikut të ekspozimit ndaj palëve të tjera, administrimit të likuiditetit, thesarit, investimeve, etj. Këto politika dhe procedura të tjera të Bankës detajojnë proceset e përzgjedhjes së kujdesshme që ndiqen kur përzgjidhen palët e tjera. Këto dokumente përcaktojnë, gjithashtu, kufijtë e ekspozimeve ndaj palëve të tjera, si edhe llojet e transaksioneve të lejuara, metodat e kontrollit dhe të monitorimit, rregullat e përpunimit, etj.

Banka ProCredit ka një tolerancë relativisht të vogël ndaj rrezikut dhe nuk përfshihet në veprimtari të tregimit spekulativ. Palët tona të tjera janë kryesisht institucione me vlerësim të lartë të kredisë, me reputacion të mirë dhe nivel të lartë të qëndrueshmërisë financiare. Në parim, asnjë ekspozim apo asnjë marrëveshje nuk mund të bëhet pa përcaktuar paraprakisht një kufi. Këto përcaktohen me anë të analizave të plota nga banka dhe rishikohen çdo vit. Politikat dhe procedurat e bankës janë në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Që nga përhapja e pandemisë COVID-19, Banka ka monitoruar cilësinë e kreditit të palëve të tjera edhe më ngushtësisht, duke ndjekur veprimet vlerësuese të agjencive të vlerësimit, lajmet në media dhe raportet e analizave. Duke marrë parasysh faktin që Banka nuk pati ndonjë investim që u ndikua nga palët e tjera për shkak të pandemisë, atëherë rreziku i ekspozimit ndaj palës tjetër dhe emetuesit mbetet i qëndrueshëm.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit dhe financimit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka nuk do të jetë në gjendje të përmbushë plotësisht ose në kohë detyrimet e saj aktuale dhe të ardhshme. Rreziku i financimit është rreziku që financimi shtesë do të mund të përfitohet me norma interesi shumë të larta ose të mos përfitohet fare.

Banka ProCredit i menaxhon këto rreziqe nëpërm-

jet politikave dhe procedurave të saj në harmoni me kërkesat e autoritetit rregullator. Përveç kësaj, kontrolli dhe zvogëlimi i rrezikut të likuiditetit mbështetet me modelin tonë të biznesit. Nga njëra anë, portofoli i huasë karakterizohet nga një numër i madh ekspozimesh afatshkurtra dhe afatmesme. Pjesa më e madhe e këtyre huave janë lëvruar si hua me anuitete dhe janë me cilësi të lartë. Nga ky këndvështrim i rrezikut të likuiditetit, kjo çon në flukse hyrëse të diversifikuara dhe të parashikueshme. Nga ana tjetër, depozitat nga klientët janë burimi ynë kryesor i financimit, kështu që përdorimi i instrumenteve të tregut financiar është në shkallë të ulët.

Si pjesë e menaxhimit të likuiditetit, Banka ka përcaktuar dhe monitoron rregullisht treguesit e saj të likuiditetit. Ne gjithashtu kryejmë rregullisht provat e rezistencës për likuiditetin bazuar në skenarë të përcaktuar që e ndihmojnë Bankën të analizojë pozicionet e saj të likuiditetit në rast të goditjeve të mundshme të brendshme ose të jashtme. Banka e konsideron rrezikun e likuiditetit si të ulët, për shkak të shumëllojshmërisë së depozitave të klientëve dhe faktit që Banka vazhdon të ketë qasje në financimin nga burime të ndryshme ndërkombëtare.

Në fillim të pandemisë, u ngrit menjëherë një grup pune për të mbikëqyrur ndikimin e COVID-19 në pozicionin e likuiditetit të bankës dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura në kohë. Çdo ditë u monitoruan dhe u vlerësuan zhvillimet, treguesit e rrezikut të likuiditetit, masat rregullatore dhe prirjet e tregut.

Menaxhimi i rrezikut valutor

Menaxhimi i rrezikut valutor nënkupton rrezikun e ndikimeve negative në rezultatet financiare dhe në mjaftueshmërinë e kapitalit të një institucioni të shkaktuar nga ndryshimet në kursin e këmbimit. Banka ProCredit e administron këtë lloj rreziku në përputhje me Politikën e Menaxhimit të Rrezikut Valutor, që është në përputhje me rregulloret e BQK-së. Pozicionet e valutave menaxhohen çdo ditë dhe kurset e këmbimit monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

Meqenëse ne nuk kemi pozicione të hapura valutore për spekulim, Banka ProCredit ka një nivel të ulët ekspozimi ndaj rrezikut valutor. Për më tepër, kufijtë e përcaktuar për këto rreziqe nuk janë tejkaluar asnjëherë në 2020.

Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit

Rreziku i normës së interesit krijohet nga ndryshimet strukturore ndërmjet ndryshimit të çmimit të aktiveve dhe pasiveve në maturim. Kjo mund ta ekspozojë bankën ndaj rrezikut të rritjeve të mundshme në kostot e financimit, ndërsa kthimi nga aktivet mund të mbetet i njëjtë, ose të bjerë, duke mos pasqyruar kështu kostot e financimit për një periudhë më të gjatë dhe duke rezultuar në rënie të marzhit.

Banka ka miratuar një politikë të duhur për këtë lloj rreziku. Ne analizojmë në mënyrë të vazhdueshme mospërputhjet në maturim ndërmjet aktiveve dhe pasiveve (në bazë të ripërcaktimit të çmimeve). Përveç kësaj, Banka bën provat e rezistencës duke simuluar luhatje të normës së interesit me qëllim që të matet ndikimi në vlerën ekonomike dhe të ardhurat nga interesat. Rezultatet e këtyre analizave raportohen rregullisht në Komitetin e Administrimit të Rrezikut Financiar dhe të Tregut, si dhe në Këshillin e Administrimit.

Menaxhimi i mjaftueshmërisë së kapitalit

Mjaftueshmëria e kapitalit të Bankës përlogaritet rregullisht dhe i raportohet Drejtimin nga Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut Financiar dhe të Tregut, së bashku me parashikimet. Kjo siguron pajtueshmëri në të ardhmen me kërkesat rregullatore për mjaftueshmërinë e kapitalit. Menaxhimi i mjaftueshmërisë së kapitalit kryhet duke u bazuar në politikat e Bankës dhe në përputhje me rregulloret përkatëse të Bankës Qendrore.

Menaxhimi i rrezikut operacional dhe të mashtrimit

Rreziku operacional, në përputhje me Komitetin e Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare, përkufizohet nga Banka si rreziku i humbjes që rezulton nga proceset e brendshme, njerëzit ose sistemet e papërshtatshme ose që dështojnë, ose nga ngjarje të jashtme. Ky përkufizim përfshin, në veçanti, rrezikun e mashtrimit, rrezikun e TI-së, rrezikun ligjor, rrezikun e reputacionit dhe rrezikun e delegimit. Banka zbaton një grup parimesh për menaxhimin e rrezikut operacional dhe të mashtrimit në të gjithë institucionin, nëpërmjet politikave specifike, parimet e të cilave janë në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore.

Mjetet kryesore të përdorura nga Banka për të administruar rreziqet operationale janë Baza e të Dhënave të Ngjarjeve të Rrezikut (RED - BDNR), vlerësimet vjetore të rrezikut, treguesit kryesorë të rrezikut (KRI) dhe analiza e të gjitha shërbimeve dhe proceseve të reja që përdorin procesin e Miratimit të Rrezikut të Ri (NRA - MRR). Banka përdor vlerësimet e rrezikut operacional dhe të mashtrimit për të identifikuar, vlerësuar dhe monitoruar rreziqet operationale në të gjitha nivelet. Në përputhje me Basel II, Banka në mënyrë të vazhdueshme vlerëson rreziqet operationale që mund të krijohen nga shërbimet, proceset dhe sistemet e saj. Përveç kësaj, sistemi i kontrollit të brendshëm të bankës përfshin procedurat e zbutjes së mangësive, duke përfshirë edhe veprimet e nevojshme ndreqëse dhe parandaluese. Për të mbajtur të minimizuara rreziqet e teknologjisë së informacionit, banka zbaton procedurat për mbrojtjen e strukturës së saj të TI-së, për të siguruar vijueshmërinë e biznesit dhe për të forcuar sigurinë e informacionit. Për më tepër, Banka ofron trajnim për Kodin e Mirësjelljes, pasi ky dokument angazhues e vë theksin në rëndësinë e integritetit të punonjësve dhe nxit kulturën e transparencës dhe të vetëdijësisimit ndaj rrezikut. Parimet e rrezikut operacional, mashtrimit dhe të sigurisë së informacionit trajtohen në trajnimet e rregullta të punonjësve dhe për krijimin e vetëdijësisimit ndaj rrezikut në të gjitha nivelet.

Në muajin mars 2020 u krijua një grup pune për të menaxhuar dhe monitoruar ndikimin e pandemisë së COVID-19 në operationet ditore të Bankë dhe për të siguruar vijueshmëri të operationeve të biznesit duke e mbështetur me personel të mjaftueshëm. Qasja digjitale e bankës për të gjitha operationet rutinë bankare ka mundësuar zbatimin shumë të shpejtë të modeleve të punës nga shtëpia për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e klientëve dhe të punonjësve. Banka, gjithashtu, ka vijuar të përqendrohet në monitorimin e rregullt të sigurisë së informacionit në bankë.

Parandalimi i pastrimit të parave

ProCredit Bank është në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin e Kosovës që ndërlidhen me parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe akteve të tjera të paligjshme. ProCredit Bank Kosovë, si pjesë e Grupit ProCredit, implementon edhe politikën, edhe standardin e Grupit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që janë në harmoni të plotë me kërkesat e legjislacionit gjerman dhe atij të BE-së.

Qasja e përgjegjshme është pjesë integrale e vlerave të modelit biznesor të Bankës ProCredit. Përgjegjësia etike e bankës është e dokumentuar në formë të Kodit të Mirësjelljes dhe Listës Përfshirëse, në të cilën janë të përfshira rregullat kryesore të cilat çdo punëtor i bankës duhet t'i vëzhgojë me vëmendje.

Ndërgjegjësimi ndaj rrezikut të PP/FT për të gjithë punonjësit e bankës, një qasje në thelb konservative ndaj menaxhimit të rrezikut, është pjesë integrale e strategjisë së biznesit të Bankës. Prandaj, i gjithë stafi i Bankës bën trajnime intensive për më të rehat nga fusha e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe sanksioneve ndërkombëtare.

Për më tepër, Njësia për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit është njësi e pavarur brenda strukturës organizative të Bankës dhe i raporton drejtpërdrejtë Bordit Drejtues të Bankës.

Banka përdor softuer të sofistikuar i cili mundëson pajtueshmërinë me sanksione ndërkombëtare, monitorimin e transaksioneve me vende me rrezikshmëri të lartë si dhe detektimin e transaksioneve potencialisht të dyshimta.

Zhvillimi i stafit

Ne besojmë tek njerëzit dhe investojmë shumë tek ta. Ne jemi të angazhuar për një këndvështrim humanist ndaj botës, duke besuar fort tek njohuritë dhe shkenca, si edhe një shkallë e lartë të inteligjencës emocionale. Kjo është ajo çka presim ne nga punonjësit tanë dhe ajo çka, për rrjedhojë, përbën shtyllat e qasjes sonë ndaj trajnimit dhe vlerësimit të punonjësve.

Përsa i përket trajnimit, ne nuk përqendrohemi vetëm tek ata pak “të lumtur”, por kemi ndërtuar një trajnim gjithëpërfshirës në vijimësi për të gjithë punonjësit tanë, për të cilët Akademia jonë në Gjermani ka luajtur një rol thelbësor që prej themelimit të saj në 2006. Për shembull:

Në 10 vitet e fundit, të gjithë kolegët tanë të rinj janë integruar nëpërmjet programit tonë 6-mujor. Sot ata përbëjnë 41% të të gjithë personelit;

Të gjithë punonjësit tanë kanë të paktën nivel B1 të anglishtes pas vitesh investimi në kurset e gjuhës angleze të drejtuara nga ekipet tona të mësuesve;

126 orë trajnimi për punonjës në 2020;

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, 24% e stafit tonë është diplomuar nga ose po merr pjesë në një nga Akademitë e ProCredit (në Akademinë për Bankier ose të Menaxhimit në Furth, Gjermani).

Kurrikuli ynë për trajnim është ngushtësisht i lidhur me sistemin tonë të vlerësimit të stafit, që i konsideron punonjësit tanë jo vetëm si pjesë e lëvizshme e makinerisë bankare, por si individë me shtegun e tyre të rritjes personale dhe profesionale. Me vetëdije ne kemi hequr dorë nga përmbledhja e rezultateve të vlerësimit të personelit tonë me anë të vrojtimit – si renditje apo madje edhe me ngjyra, siç ndodh rëndom në kompani të mëdha dhe në vend të kësaj jemi përqendruar në vendosjen e një dialogu të hapur dhe gjithëpërfshirës dhe në rënien dakord për hapa konkretë të zhvillimit me secilin prej punonjësve tanë.

Suksesi i strategjisë tonë të biznesit dhe aftësia jonë për të ofruar shërbim të vlefshëm për klientët tanë mbështetet në aftësitë dhe qëndrimin e punonjësve tanë. Ne synojmë të ndërtojmë një institucion të fortë, të dukshëm, të qëndrueshëm, të ndërtuar mbi angazhimin për zhvillim të punonjësve dhe një grup themelor të parimeve etike. Ne synojmë të mbështesim një kulturë korporative proaktive, produktive dhe profesionale, si edhe me përgjegjësi shoqërore, ku punonjësit tanë gëzojnë një perspektivë afatgjatë dhe mundësi zhvillimi profesionale me karrierë të gjatë. Tashmë ka një numër nismash kryesore që janë konsoliduar mirë:

Trajnime të strukturuar për punonjësit e rinj, që fillojnë me programin online 6-mujor me bursë “Programi i integritit”;

Struktura e pagave të grupit, që parashikon paga më të larta për punonjësit dhe menaxherët e nivelit të mesëm më të kualifikuar dhe që kanë rezultate e arritje të larta;

Përshkrimet e punës rishikohen rregullisht, në kontekstin e specializimit të kategorisë së klientit dhe të infrastrukturës së degës, si edhe që janë të sistematizuara horizontalisht në të gjithë bankën;

Një qasje gjithëpërfshirëse për vlerësimin e punonjësve që është zhvilluar me qëllim që të mundësohet zhvillimi profesional i personalizuar për secilin punonjës të bankës;

Përveç këtyre, përmes programeve të trajnimit të ofruara për punonjësit dhe menaxherët ekzistues në të gjitha nivelet, banka përkushtohet që të sigurojë që aftësitë, njohuritë dhe efienca e nevojshme për të gjithë punonjësit të jenë në nivele të përshtatshme në çdo kohë.

Për rrjedhojë, në 2021 në fokus do të vijojë të jetë zhvillimi i mëtejshëm i Këshilltarëve tanë të Klientëve dhe Këshilltarëve tanë të Klientëve të Biznesit – për të rritur shërbime dhe këshilla më të mira për klientët tanë, si edhe për një menaxhim efektiv të rrezikut kreditor.

Aftësia e personelit për të ofruar shërbime të mira për klientët dhe me produktivitet të lartë do të vijojë të mbështetet me mjete teknologjike dhe procese eficiente. Në bankë do të përmbushen një numër nismash kyçe, të cilat do të vijnë të sjellin përfitime në 2021:

- Zbatimi i Bankimit të Drejtpërdrejtë;
- Një qasje më e targetuar për klientët privatë;
- Nevojat e klientit dhe përparimi teknologjik kërkojnë një ofertë të thjeshtë dhe të standardizuar;
- Ofrimi i shërbimit të jetë i qasshëm, i plotë dhe që i jep autonomi klientëve;
- Zonat 24/7;

Centralizimi i ekipeve të huadhënies për Klientët Privatë në Drejtorinë Qendrore, për të siguruar vendimmarrje më të mirë.



RAPORTI I AUDITORTI TË PAVARUR

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME
2. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL
 - (A) BAZA E PËRGATITJES
 - (B) INTERESI
 - (C) TARIFAT DHE KOMISIONET
 - (D) QIRATË
 - (E) TRANSAKSIONET NË VALUTË TË HUAJ
 - (F) TATIMI MBI FITIM
 - (G) INSTRUMENTET FINANCIARE
 - (H) PARAJA E GATSHME DHE EKUIVALENTET E PARASË
 - (I) KREDITË DHE PARADHËNIET
 - (J) INVESTIMET NË LETRAT ME VLERË
 - (K) PRONA DHE PAJISJET
 - (L) PASURITË E PAPERKSHME
 - (M) KOLATERALI I MARRË NË PRONËSI
 - (N) TË ARKËTUESHMET NGA BANKAT E TJERA
 - (O) DEPOZITAT DHE DETYRIMET E VARURA
 - (P) PROVIZIONET
 - (Q) PËRFITIMET E PUNONJËSVE
 - (R) GARANCIONET FINANCIARE DHE ZOTIMET E HUASË
 - (S) KAPITALI AKSIONAR
3. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA
4. GJYKIME KRITIKE KONTABËL DHE BURIMET KYÇE TË VLERËSIMIT TË PASIGURISË
5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR
 - (A) RISKU I TREGUT
 - (B) RISKU I KREDISË
 - (C) RISKU I LIKUIDITETIT
 - (D) MENAXHIMI I KAPITALIT
 - (E) KAPITALI EKONOMIK
6. VLERA E DREJTË E INSTRUMENTEVE FINANCIARE
 - A. MODELET E VLERËSIMIT
 - B. INSTRUMENTET FINANCIARE TË MATURA NË VLERË TË DREJTË
 - C. INSTRUMENTET FINANCIARE JO TË MATURA NË VLERË TË DREJTË PËR TË CILAT SHPALOSET VLERA E DREJTË
7. TË HYRAT NETO NGA INTERESI
8. TË HYRAT NETO NGA TARIFAT DHE KOMISIONET
9. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE DHE SHPENZIMET E TJERA OPERATIVE
10. TATIMET NË FITIM
11. PARAJA E GATSHME DHE BALANCAT ME BANKAT QENDRORE
12. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR BANKAT
13. KREDITË DHE P PARADHËNIET PËR KLIENTËT
14. INVESTIME NË LETRA ME VLERË TË MATURA ME VDPHTGJ
15. PASURITË E PAPERKSHME
16. PRONA DHE PAJISJET
17. PASURITË TJERA FINANCIARE
18. PASURITË TJERA
19. DETYRIMET NDAJ BANKAVE
20. DETYRIMET NDAJ KLIENTËVE
21. DETYRIME TË TJERA FINANCIARE
22. DETYRIME TË TJERA
23. HUAMARRJET DHE BORXHI I VARUR
24. KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT
25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA
26. ZOTIMET DHE KONTINGJENCAT
27. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT



Deloitte Kosova sh.p.k.
St. Lidhja e Pejës, 177
10000 Prishtina Kosova
Tel: +381 38 760 300
Fax: +381 38 760 344
www.deloitte.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Bordin e Drejtorëve të ProCredit Bank Sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ProCredit Bank sh.a (“Banka”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 si dhe shënimet lidhur me pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2020 dhe performancën e saj financiare si dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përkruhen më tej në Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare, si pjesë e raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi IESBA) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Informatat e tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informatat e tjera. Informatat e tjera përbëjnë informatat e përfshira në raportin vjetor të bankës në përputhje me kërkesat e ligjit numër 04/L-093. Raporti vjetor i bankës pritet të jetë në dispozicionin tonë pas datës së raportit të auditimit. Opinioni jonë mbi pasqyrat financiare nuk i mbulon informatat e tjera dhe ne nuk do të shprehim ndonjë siguri mbi to.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informatat e tjera të identifikuara më lart kur ato të jenë në dispozicion dhe duke bërë këtë, të shqyrtojmë nëse informatat tjera janë jo konsistente me pasqyrat financiare, ose me njohuritë tona të fituara gjatë auditimit ose nuk janë të deklaruara në mënyrë të drejtë. Kur ne lexojmë raportin vjetor të bankës, nëse vijmë në përfundim se ka gabime materiale, nga ne kërkohet të komunikojmë këtë çështje tek personat e ngarkuar më qeverisje.

Deloitte.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen mbi pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe për kontrollin e brendshëm që menaxhmenti e përcakton të domosdoshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së bankës për të vazhduar aktivitetin, duke shpalosur, sipas rastit, çështjet që kanë të bëjnë me vazhdimësinë e biznesit dhe duke përdorur bazën e vijimësisë të kontabilitetit, përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë bankën ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka alternativë reale, përveç se ta bëjë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe për të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Sigurimi i arsyeshëm është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithmonë ndonjë gabim material kur ai ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, ato në mënyrë të arsyeshme pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë e procedura të auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve dhe marrim prova të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se ai që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë fshehje, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë në përshtatshme me rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të menaxhimit të bazës së vijimësisë të kontabilitetit dhe në bazë të provave të auditimit të fituara, nëse ekziston një pasiguri materiale që lidhet me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar aktivitetin. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, na kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit tonë në shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto dhënie informacionesh shpjeguese janë jo adekuate, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në provat e auditimit të fituara deri në datën e raportit të auditorit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Banka të pushojë së vazhduari aktivitetin.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, ndër të tjera çështje, fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Deloitte Kosova sh.p.k

Deloitte Kosova sh.p.k.
Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177,
Prishtinë, Republika e Kosovës
Nr. unik identifikues: 810468373
26 prill 2021



Arta Limani

Partnere e angazhimit:
Arta Limani

PROCREDIT BANK SH.A.**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë shprehur në mijë Euro)

	Shënim	2020	2019
Të hyrat nga interesi të llogaritur duke përdorur metodën efektive të interesit	7	27,866	29,512
Të hyrat e tjera të interesit	7	145	438
Shpenzimet e interesit	7	(2,349)	(1,957)
Të hyrat neto nga interesi		25,662	27,993
Lejimi për humbjen nga zhvlerësimi për huatë dhe paradhëniet për klientët	13	(2,671)	8,453
Të ardhurat neto nga interesi pas lejimit për humbjen nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve ndaj klientëve		22,991	36,446
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	8	12,235	14,000
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet	8	(5,078)	(5,040)
Fitimet minus humbjet nga tregtimi dhe këmbimi valuator		780	890
Të hyrat tjera operative		747	2,065
Shpenzimet administrative dhe të tjera operative	9	(17,542)	(24,181)
Fitimi para tatimit		14,133	24,180
Tatimi në fitim	10	(883)	(2,728)
Fitimi i vitit		13,250	21,452
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse:			
<i>Zërat që mund të ri-klasifikohen në fitim ose humbje në periudhat e më vonshme:</i>			
Investimi në letrat me vlerë matura me VDPHTGJ			
Fitimet minus humbjet gjatë vitit, neto nga tatimi	10	(67)	92
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin		13,183	21,544

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet dhe pjesët përbërëse të pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 59.

PROCREDIT BANK SH.A.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë shprehur në mijë Euro)

	Shënime	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Pasuritë			
Paraja dhe gjendja me Bankat Qendrore	11	263,076	157,945
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	12	39,916	40,710
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	13	514,254	505,260
Investimet në letrat me vlerë të matura me VDPHTGJ	14	64,955	86,999
Pasuritë e tjera financiare	17	1,851	2,319
Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat	10	1,527	1,061
Paruritë e shtyera tatimore	10	183	-
Pasuritë e tjera	18	939	1,262
Pasuritë e paprekshme	15	51	20
Prona dhe pajisje	16	13,240	10,354
Gjithsej pasuritë		<u>899,992</u>	<u>805,930</u>
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave	19	608	715
Detyrimet ndaj klientëve	20	749,798	673,113
Detyrimet tjera financiare	21	1,249	1,436
Detyrimet tjera	22	4,682	4,819
Detyrimet e shtyera tatimore	10	-	448
Huamartjet	23	24,981	19,906
Borxhi i varur	23	7,537	7,538
Gjithsej detyrimet		<u>788,855</u>	<u>707,975</u>
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	24	61,346	61,346
Primi i aksioneve	24	4,204	4,204
Rezerva kontingjente	24	511	511
Rezerva e ri-vlerësimit për investimet në letrat me vlerë të matura me VDPHTGJ	24	74	141
Fitimi i mbajtur		45,002	31,753
Gjithsej ekuiteti		<u>111,137</u>	<u>97,955</u>
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		<u>899,992</u>	<u>805,930</u>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet dhe pjesët përbërëse të pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 59.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Bordi Menaxhues dhe janë nënshkruar në emër të tyre më 26 prill 2021 nga:

 Eriola Bibolli
 Drejtoreshë ekzekutive

 Esad Haxhani
 Udhëheqës i departamentit të
 financave

PROCREDIT BANK SH.A.
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
 Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020
 (Shumat janë shprehur në mijë Euro)

	Shënime	2020	2019
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		14,133	24,180
Rregullimet për:			
Zhvlerësim	16	1,400	2,063
Amortizim	15	13	22
Rënia në vlerë e pasurive fikse	16	176	1,062
Fitimi nga shlyerja e pronës dhe pajisjeve		(90)	(528)
Humbja nga rënia në vlerë	13	2,671	(8,453)
Të hyrat nga interesi	7	(28,011)	(29,950)
Shpenzimet e interesit	7	2,349	1,957
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		(7,359)	(9,647)
Neto (rritja)/ zvogelim në:			
Të arkëtueshmet nga bankat e tjera		9,325	(9,845)
Kreditë dhe paradhëniet për klientët		(11,120)	(4,153)
Pasuritë tjera		323	576
Pasuritë tjera financiare		477	349
Gjendja me Bankën Qendrore		(5,340)	(1,076)
Neto rritja/(zvogëlimi) në:			
Detyrimet ndaj bankave		(107)	237
Detyrimet ndaj klientëve		76,492	33,412
Detyrimet tjera		(464)	2,534
Detyrimet tjera financiare		(187)	672
		62,040	13,059
Interesi i arkëtuar		27,427	30,074
Interesi i paguar		(2,122)	(1,698)
Tatimi i paguar në të ardhura		(1,526)	(2,322)
Paraja neto e gjeneruar/ (përdorur në) nga aktivitetet operative		85,819	39,113
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e investimeve në letrat me vlerë përmes VDPHTGJ		(53,863)	(33,116)
Të ardhurat nga shitja e investimeve në letrave me vlerë përmes VDPHTGJ		75,762	31,150
Blerja e pronës dhe pajisjeve	16	(4,596)	(3,778)
Të ardhurat nga shlyerja e pronës dhe pajisjeve	16	245	5,311
Blerja e pasurive të paprekshme	15	(45)	(9)
Paraja neto (e përdorur në) /nga aktivitetet investuese		17,503	(442)
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet financuese			
Të ardhurat nga huazimet afatgjata		5,000	10,000
Pagesa e dividendës	24	-	(17,000)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financuese		5,000	(7,000)
Rënia neto në para dhe ekuivalentët e parasë		108,322	31,675
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		143,560	111,885
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	11	251,882	143,560

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet dhe pjesët përbërëse të pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 59.

PROCREDIT BANK SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020
 (Shumat janë shprehur në mijë Euro)

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Rezerva kontigjente	Fitimi i mbajtur	Rezerva e vlerës së drejtë	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2019	61,346	4,204	511	27,300	49	93,410
Fitimi për vitin	-	-	-	21,452	-	21,452
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	92	92
Gjithsej të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	21,452	92	21,544
Dividenda e paguar	-	-	-	(17,000)	-	(17,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	61,346	4,204	511	31,753	141	97,955
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse						
Fitimi për vitin	-	-	-	13,250	-	13,250
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	(67)	(67)
Gjithsej të hyrat tjera gjithëpërfshirëse				13,250	(67)	13,183
Dividenda e paguar	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	61,346	4,204	511	45,002	74	111,137

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet duhet të lexohet së bashku me shënimet dhe pjesët përbërëse të pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 59.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

1. Informata të përgjithshme

ProCredit Bank sh.a. Kosova ("Banka") është themeluar në Republikën e Kosovës më 9 dhjetor 1999 si shoqëri aksionare. Banka filloi veprimtarinë e saj më 12 janar 2000.

Banka është kompani bijë e zotëruar plotësisht nga ProCredit Holding AG & Co. KGaA (ProCredit Holding).

Aktiviteti kryesor: Banka është licencuar për të vepruar si bankë në të gjitha fushat bankare në Kosovë sipas rregullave të Bankës Qendrore të Kosovës (ish-Autoritetit Bankar Qendror të Kosovës) ("BQK") dhe aktualisht është subjekt i ligjit "Për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare", nr. 04/L-093. ProCredit Bank ishte banka e parë e licencuar në Kosovë. ProCredit Bank sh.a. është një bankë komerciale e orientuar drejt zhvillimit, e cila ofron shërbime të klientëve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe për individët privatë. Në operacionet e saj, ajo i përmbahet një numër parimesh kryesore: vlerëson transparencën në komunikimin e saj me klientët; kërkon të minimizojë gjurmët ekologjike; dhe ofron shërbime të cilat janë të bazuara në kuptueshmërinë e situatës së secilit klient si dhe në një analizë të shëndoshë financiare.

Adresa e regjistruar dhe vendi i biznesit Adresa e regjistruar e Bankës është Rr. "George Bush", numër 26, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. Gjatë vitit 2020, përveç ofrimit të shërbimeve online përmes platformës e-Banking dhe shërbimeve në faqen e internetit, Banka ka operuar me degë, qendra shërbimi, pika shërbimi dhe zona 24/7 (vetë-shërbim) për t'i ofruar klientëve shërbime gjithëpërfshirëse dhe më të arritshme.

Bordi i Drejtorëve:

- Z. Gabriel Schor Kryetar
- Z. Marcel Zeiting, Anëtar
- Z. Rainer Ottenstein, Anëtar
- Z. Jordan Damçevski, Anëtar
- Z. Artane Rizvanolli Berisha, Anëtare
- Z. Eriola Bibolli Anëtare

2. Politika të rëndësishme kontabël

(a) Baza e përgatitjes

Deklarata e përputhshmërisë. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") sipas konventës historike, e modifikuar sipas rivlerësimit të investimeve në letrat me vlerë të matura me VDPHTGJ. Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur në vijim. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe.

Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve. Raportimi financiar dhe rezultatet financiare të Bankës ndikohen nga supozimet, vlerësimet, dhe gjykimet e menaxhmentit, të cilat duhet të ndërmerren gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Të gjitha supozimet dhe vlerësimet bëhen në përputhshmëri me standardet e aplikueshme. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme, dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorët e tjerë, duke përfshirë pritjet për ngjarjet e ardhshme që konsiderohen të duhura në rrethanat e dhëna. Rishikimet për vlerësimet njihen në mënyrë prospektive. Informacioni për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumatat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 4, 5 dhe 6.

COVID 19

Më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli COVID-19 një pandemi globale. Autoritetet e Qeverisë së Kosovës zbatuan masa për frenimin e përhapjes dhe minimizimin e ndikimit të COVID-19, siç janë: ndalimet dhe kufizimet e udhëtimit, karantina, ndihma financiare dhe pagesa e pagave për ata që u detyruan t'i ndërprisnin kontratat e punës. Këto masa u zvogëluan gradualisht nga fundi i vitit 2020 dhe 2021 pasi numri i rasteve u zvogëlua dhe situata u përmirësua. Këto masa kanë penguar rëndë veprimtarinë ekonomike në Kosovë duke ndikuar negativisht dhe pritset se do të vazhdojnë të ndikojnë negativisht në bizneset, pjesëmarrësit e tregut, klientët e Bankës për një periudhë të panjohur kohore. Që nga fillimi i pandemisë COVID-19 në Kosovë, fokusi kryesor i bankës ka qenë sigurimi i kushteve të sigurta të punës për punonjësit e bankës si dhe vazhdimësia e aktiviteteve të biznesit.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(a) Baza e përgatitjes (vazhdim)

COVID 19 (vazhdim)

Qasja dixhitale e bankës ndaj operacioneve bankare ka mundësuar punën nga shtëpia dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e klientëve dhe punonjësve të bankës. Kërkesa e rritur për të punuar nga distanca (p.sh. nga shtëpia) në përputhje me kërkesat e sigurisë që lidhen me pandeminë COVID-19 ka rritur rëndësinë e ruajtjes së një ambienti të besueshëm dhe të sigurt për çasje në distancë. Siguria dhe besueshmëria e infrastrukturës së IT-së të ndërtuar në fushën e qendrave të të dhënave të bankave dhe projektit të centralizimit të sistemeve të IT-së ofron një bazë solide për një mjedis efektiv të funksionimit të punës nga shtëpia. Për t'iu përshtatur situatës së krijuar, nevojiten pajisje shtesë për të vazhduar biznesin e përditshëm pa ndonjë ndërprerje. Në një periudhë shumë të shkurtër, i gjithë stafi ishte pajisur me laptopë për të vazhduar punën nga shtëpia. Vlera e përafërt e këtyre shpenzimeve kapitale të paplanifikuara gjatë vitit 2020 ishte 202 mijë euro.

Covid-19 i shkaktoi vendit tonë një rënie ekonomike, e cila u reflektua në mënyrë të pashmangshme tek klientët e bankës duke u shkakuar atyre shumë vështirësi financiare. Një nga masat e menjëhershme të marra nga banka gjatë Covid-19 ishte moratoriumi për ripagimet e kredive, i cili në mënyrë efektive u lejoi klientëve të shtyenin ripagimet e borxheve kur të ardhurat e tyre ishin të ulëta. Ky trajtim konsiderohet si efektiv për të mbështetur një përmirësim indirekt të likuiditetit për klientët në sektorët më të prekur dhe për të përmirësuar gradualisht situatën e përgjithshme financiare dhe aftësinë e ripagimit të kredive nga klientët. Për më tepër, kjo i lejoi Bankës të ruajë cilësinë e portfolios së kredisë derisa klientët të rikuperohen plotësisht nga kufizimet e tyre financiare.

Përkundër pandemisë, Banka ka arritur të ketë një pozicion shumë të qëndrueshëm të likuiditetit. Si rezultat, nuk kishte nevojë për fonde shtesë dhe vazhdoi të përmbushë detyrimet e saj në kohë. Zhvillimet në likuiditetin dhe rrezikun e financimit u monitoruan dhe u vlerësuan çdo ditë dhe gjithashtu u vënë në dukje rregullisht nga Banka. Sipas menaxhimit të kapitalit, Banka ka vazhduar të jetë e mirë-kapitalizuar. Për shkak të situatës së pasigurt të krijuar nga pandemia COVID-19 dhe gjithashtu udhëzimeve përkatëse nga qeveria, Banka nuk ka shpërndarë dividendë gjatë vitit 2020. Nga ana tjetër, duke marrë parasysh bazën e fortë të kapitalit të Bankës, nuk kishte nevojë për ndonjë rritje të kapitalit. Kapitali është menaxhuar, planifikuar dhe vënë në dukje në baza të rregullta.

Monedha funksionale dhe prezantimi. Këto pasqyra financiare janë paraqitur në euro, e cila është monedha funksionale e Bankës, monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin njësia vepron. Të gjitha shumat janë rumbullaksuar në mijërat më të afërt, përveç kur tregohet ndryshe.

(b) Interesi

Norma efektive e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. "Norma efektive e interesit" është norma që saktësisht zbrit pagesat dhe arkëtimet e vlerësuara të ardhshme të parasë përmes jetës së pritur të instrumenteve financiare:

- vlera kontabël bruto e pasurive financiare, ose
- kostoja e amortizuar e detyrimeve financiare.

Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit për instrumentet financiare tjera nga ato të blera ose të emetuara me rënie kreditore, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e pritura kreditore (ECL). Për pasuritë financiare të blera ose emetuara me rënie në vlerë, llogaritet një normë efektive e interesit rregullues të kredisë duke përdorur flukset monetare të ardhshme të vlerësuara duke përfshirë ECL.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot dhe tarifën e transaksionit si dhe pikat e paguara ose të pranuar që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një pasurie financiare ose detyrimi financiar.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Kostoja e amortizuar dhe vlera kontabël bruto

“Kostoja e amortizuar” e një pasurie financiare ose detyrimi financiar është shuma në të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus ripagimet e kryegjësë plus ose minus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo ndryshimi midis asaj vlere fillestare dhe shumës në maturim, dhe për pasuritë financiare, të rregulluara për çdo lejim të humbjes së kredisë.

“Vlera kontabël bruto e një pasurie financiare” është kostoja e amortizuar e një pasurie financiare përpara se të korrigjohet për çdo lejim të prishëm të humbjes së kredisë.

Llogaritja e të hyrave dhe shpenzimeve nga interesi

Norma efektive e interesit të një pasurie financiare ose detyrimi financiar llogaritet në njohjen fillestare të një pasurie financiare ose një detyrimi financiar. Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit zbatohet në vlerën kontabël bruto të pasurisë (kur pasuria nuk ka rënie në vlerë kreditore) ose në koston e amortizuar të detyrimit. Norma efektive e interesit rishikohet si rezultat i rivlerësimit periodik të flukseve të mjeteve monetare të instrumenteve me normë të ndryshueshme për të pasqyruar lëvizjet në normat e interesit të tregut. Norma efektive e interesit rishikohet gjithashtu për rregullimet në vlerën e drejtë për mbrojtje nga risku, në datën kur fillon amortizimi i rregullimit të mbrojtjes nga risku. Sidoqoftë, për pasuritë financiare që kanë pësuar rënie kreditore pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar të pasurisë financiare. Nëse pasuria nuk është më e vlerësuar për rënie kreditore atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi rikthehet në bazë bruto. Për pasuritë financiare të cilat kanë qenë me rënie kreditore në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit të rregulluar për rënie kreditore në koston e amortizuar të pasurisë. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në bazë bruto, edhe nëse rreziku i kredisë së pasurisë përmirësohet.

(c) Tarifat dhe komisionet

Tarifat që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit përfshijnë tarifën fillestare të arkëtuara ose të paguara nga subjekti lidhur me krijimin ose blerjen e pasurive financiare ose lëshimin e detyrimeve financiare, për shembull, tarifën për vlerësimin e aftësisë për kthimin e kredisë, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive ose kolateralit, negocimin e kushteve të instrumenteve dhe tarifën për përpunimin e dokumentacionit të transaksionit. Tarifat e zotimit të arkëtuara nga banka për të krijuar kredi me normat e interesit të tregut, janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit nëse është e mundshme që banka të hyjë në një marrëveshje specifike për kredidhënie dhe nuk pret ta shesë kredinë menjëherë pas krijimit së saj.

Të gjitha tarifat e tjera, të cilat janë pjesë përbërëse e llogaritjes së normës efektive të interesit, paraqiten në zërin e të ardhurave nga interesi. Të gjitha tarifat e tjera, komisionet dhe zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të tjera përgjithësisht regjistrohen në bazë akruale duke iu referuar përfundimit të transaksionit specifik mbi bazën e shërbimeve reale të kryera si përqindje e shërbimeve të përgjithshme, të cilat do të ofrohen. Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet përbëhen nga tarifat dhe komisionet nga (për): kartat e kreditit, tarifën e shërbimit të llogarisë, pagesat ndërkombëtare, pagesat vendore, tarifën e Bankës Qendrore, SMS banking, garancitë dhe letrat e kreditit si dhe tarifën dhe komisionet tjera. Tarifat dhe komisionet e tjera njihen kur shërbimet ofrohen. Shpenzimet e tjera të tarifave dhe komisioneve kanë të bëjnë kryesisht me tarifën e transaksionit dhe shërbimit, të cilat njihen si shpenzim kur shërbimet janë pranuar.

(d) Qiratë

Banka vlerëson nëse një kontratë përmban një qira, në fillimin e kontratës. Banka njeht një aset të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim të qirasë në lidhje me të gjitha kontratat e qirasë në të cilat është qiramarrës, përveç qirave afatshkurtra (me afat 12 muaj ose më pak) dhe qirave të aseteve me vlerë të ulët (kompjuterë personalë, sende të vogla, mobilje për zyre dhe telefona). Për këto qira, Banka njeht pagesat e qirasë si një shpenzim operativ mbi një bazë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë, përveç nëse një bazë tjetër sistematike e modelit kohor

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Qiratë (vazhdim)

në të cilin konsumohen përfitimet ekonomike nga asetet me qira është më e duhur. Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, duke e zbritur për normën e skontimit. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, Banka përdor normën e saj të kredimarrjes. Në përgjithësi, Banka përdor normën mesatare të interesit për kreditë e biznesit si normë skontimi.

(e) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta të huaja janë kthyer në valutën funksionale, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Asetet dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj rivlerësohen në valutën funksionale të bankës me kursin e datës së raportimit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në valutën funksionale në fillim të periudhës, të rregulluara për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në valutë të huaj të kthyer në valutë funksionale me kursin e fundvitit. Diferencat nga kursi i këmbimit, të cilat rrjedhin nga rivlerësimi në valutën funksionale, njihen në fitim ose në humbje.

(f) Tatimi në fitim

Tatimet në fitim janë paraqitur në pasqyra financiare në përputhje me legjislacionin e miratuar, si dhe me legjislacionin e hyrë në fuqi deri në fund të periudhës raportuese.

Ngarkesa e tatimit në fitim përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi në fitim i shtyrë dhe njihet në pasqyrën e fitimit dhe të humbjes së vitit, përveç nëse njihet në të ardhurat tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital, pasi që ndërlidhet me transaksionet të cilat gjithashtu njihen në periudhën e njëjtë ose në periudhë tjetër, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është shuma e pagueshme ose e arkëtueshme nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe paraprake. Fitimet dhe humbjet e tatueshme bazohen në vlerësime nëse pasqyrat financiare autorizohen para dorëzimit të kërkesave relevante për rimbursim të tatimit. Tatimet tjera të ndryshme nga tatimi në fitim regjistrohen në kuadër të shpenzimeve administrative dhe operative.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë në të ardhura llogaritet duke përdorur metodën e detyrimit të bilancit të gjendjes për bartjet e humbjeve nga tatimi dhe diferencat e përkohshme që dalin nga baza e tatimeve të pasurive dhe detyrimeve dhe shumat e tyre bartëse për qëllime të raportimit financiar. Gjendja e tatimit të shtyrë matet me normat tatimore në fuqi ose të hyra në fuqi në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të aplikohen për periudhën kur diferencat e përkohshme të kthehen ose kur bartjet e humbjeve nga tatimi të përdoren. Pasuritë tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe bartjet e humbjeve nga tatimi regjistrohen deri në masën që është e mundur për të pasur të ardhura të tatueshme kundrejt të cilave ky aset tatimor pritet të përdoren.

(iii) Pozicionet tatimore të pasigurta

Pozicionet tatimore të pasigurta të bankës rivlerësohen nga menaxhmenti në fund të secilës periudhë raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet tatimore të pasigurta, të cilat përcaktohen nga menaxhmenti si të tilla që ka më shumë gjasa se nuk do të rezultojnë me taksa shtesë të vëna nëse ato pozicione do të kontestoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore të cilat janë në fuqi, ose që kanë hyrë në fuqi deri në fund të periudhës raportuese dhe çdo aktvendimi gjyqësor të njohur ose të ndonjë organi tjetër lidhur me çështje të tilla. Detyrimet për dënime, interes dhe tatime të ndryshme nga ato në fitim njihen në bazë të vlerësimeve më të mira të shpenzimeve të bëra nga menaxhmenti që kërkohen për shlyerjen e detyrimeve në fund të periudhës raportuese.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Banka fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, depozitat dhe borxhin e varur në datën që ato janë emetuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (duke përfshirë dhe blerjet e shitjet e rregullta të aktiveve financiare) njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Një aset ose detyrim financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, për një vlerë që nuk është matur në VDPFH, kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Pasuritë financiare

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur në: koston e amortizuar, VDPHTGJ ose VDPFH. Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- aset mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare ngriten në datat e përcaktuara në flukset e mjeteve monetare që janë SPPI.

Një pasuri financiare matet me VDPHTGJ nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- aset mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare japin në datat e përcaktuara flukset e mjeteve monetare që janë SPPI.

Të gjitha pasuritë e tjera financiare klasifikohen si të matura VDPFH. Përveç kësaj, në njohjen fillestare, Banka mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një pasuri financiare që plotëson kërkesat e tjera që duhet të matet me koston e amortizuar ose në VDPHTGJ si në VDPFH, nëse bën kështu eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje kontabël që do të lindte ndryshe.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Banka bën një vlerësim të objektivit të një modeli biznesi në të cilin një pasuri është mbajtur në nivel portofoli, sepse kjo më së miri pasqyron mënyrën se si menaxhohet biznesi dhe i jepet informacion menaxhimentit. Informacioni i konsideruar përfshin:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolio dhe funksionimin e këtyre politikave në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e menaxhmentit fokusohet në fitimin e të ardhurave nga interesi kontraktual, duke ruajtur një profil të caktuar të normës së interesit, duke përputhur kohëzgjatjen e pasurive financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë ato pasuri ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së pasurive;
- si vlerësohet dhe raportohet performanca e portofolit tek menaxhmenti i Bankës;
- rreziqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi) dhe strategjisë së saj për mënyrën se si menaxhohen këto rreziqe;
- frekuenca, vëllimi dhe koha e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për shitjet e tilla dhe pritshmëritë e tij për aktivitetin e ardhshëm të shitjes. Megjithatë, informacioni rreth aktivitetit të shitjeve nuk konsiderohet veç e veç, por si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm se si është arritur objektivi i Bankës për menaxhimin e aktiveve financiare dhe si realizohen flukset monetare.

Pasuritë financiare që mbahen për tregtim ose menaxhim dhe performanca e të cilave vlerësohen në bazë të vlerës së drejtë, maten në VDPFH sepse ato as nuk mbahen për të mbledhur flukse monetare kontraktuale as për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur aktivet financiare.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit

Për qëllimet e këtij vlerësimi, 'kryegjëja' përcaktohet si vlera e drejtë e aktivitet financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' përcaktohet si një shpërblim për vlerën kohore të parasë dhe për rrezikun e kredisë që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), si dhe si margjinë fitimprurëse.

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë SPPI, Banka konsideron kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse pasuria financiare përmban një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që ajo të mos plotësojë këtë kusht. Gjatë marrjes së vlerësimit, Banka e konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që do të ndryshonin shumën dhe kohën e flukseve të mjeteve monetare;
- karakteristikat e levave;
- parapagimi dhe afatin e zgjatjes;
- kushtet që kufizojnë pretendimin e Bankës për flukset e mjeteve monetare nga pasuritë e specifikuar (p.sh. kreditë pa rekurs); dhe
- karakteristika që modifikojnë konsideratën për vlerën kohore të parasë (p.sh. rivendosjen periodike të normave të interesit).

Banka mban një portofol kredie afatgjatë me normë fikse për të cilën Banka ka mundësi të propozojë rishikimin e normës së interesit në datat e rivendosjes periodike. Këto të drejta të rivendosjes janë të kufizuara në normën e tregut në kohën e rishikimit. Huamarrësit kanë një mundësi që të pranojnë normën e rishikuar ose të shlyejnë huanë në parim pa dënim. Banka ka përcaktuar që flukset monetare kontraktuale të këtyre kredive janë SPPI sepse opsioni ndryshon normën e interesit në një mënyrë që është konsideratë për vlerën në kohë të parasë, rrishtun e kredisë, rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe kostot që lidhen me shumën kryesore të papaguar.

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Kreditë pa rekurs

Në disa raste, huatë e bëra nga Banka që sigurohen me kolateral të huamarrësit kufizojnë kërkesën e Bankës ndaj flukseve të mjeteve monetare të kolateralit bazë (huatë pa rekurs). Banka zbaton gjykime për të vlerësuar nëse huatë e rekursit përmbushin kriterin e SPPI. Banka zakonisht e konsideron informacionin e mëposhtëm kur bën këtë gjykim:

- nëse marrëveshja kontraktuale specifikon në mënyrë të veçantë shumat dhe datat e pagesave në para të kredisë;
- vlera e drejtë e kolateralit në raport me shumën e aktivitet financiar të siguruar;
- aftësinë dhe gatishmërinë e huamarrësit për të bërë pagesa kontraktuale, pavarësisht nga rënia e vlerës së kolateralit;
- nëse huamarrësi është një individ ose një entitet ekonomik operative i pavaruar ose është një entitet me qëllim të përcaktuar;
- rreziku i humbjes së pasurisë nga Banka në lidhje me një hua të plotë rekursive;
- masën në të cilën kolaterali përfaqëson të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të aktiveve të huamarrësit; dhe
- nëse Banka do të përfitojë nga ndonjë ngritje nga aktivitet themelore.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (Vazhdim)

Riklasifikimet

Pasuritë financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën kur Banka ndryshon modelin e biznesit për menaxhimin e pasurive financiare.

(iii) Ç'regjistrimi

Pasuritë financiare

Banka çregjistron një pasuri financiare kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare (shih gjithashtu (iv)) ose kur transferon të drejtat për të marrë flukset e mjeteve monetare kontraktuale në një transaksion në të cilin në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar ose në të cilat Banka nuk transferon as nuk mban në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e pasurisë financiare.

Me rastin e ç'regjistrimit të një pasurie financiare, diferenca midis vlerës kontabël neto të pasurisë (ose vlerës kontabël të shpërndarë në pjesën e aktivitetit të ç'regjistruar) dhe shumës së (i) vlerës së marrë (përfshirë çdo pasuri të re të marrë më pak se çdo detyrim të ri të supozuar) dhe (ii) çdo fitim ose humbje kumulative që ishte njohur në HTGJ njihet në fitim ose humbje.

Çdo fitim/humbje kumulative e njohur në HTGJ në lidhje me letrat me vlerë të kapitalit të investuara të përcaktuar si në VDPHTGJ, nuk njihet në fitim ose humbje për ç'regjistrimin e letrave të tilla me vlerë. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për ç'regjistrim që është krijuar ose mbajtur nga Banka njihen si një pasuri ose detyrim i veçantë.

Banka hyn në transaksione me të cilat transferon pasuritë e njohura në pasqyrën e saj të pozicionit financiar, por ruan të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pasurive të transferuara ose një pjesë të tyre. Në raste të tilla, pasuritë e transferuara nuk çregjistrohen. Shembuj të transaksioneve të tilla janë huatë e letrave me vlerë dhe transaksionet e shitjes dhe riblerjes.

Kur pasuritë i shiten një pale të tretë me një normë totale të kthimit në pasuritë e transferuara, transaksioni trajtohet si një transaksion financiar i siguruar, i ngjashëm me transaksionet e shitjes dhe të riblerjes, sepse Banka mban në thelb të gjitha ose një pjesë të konsiderueshme të rreziqeve dhe përfitimeve nga pronësia e këtyre pasurive.

Në transaksionet në të cilat Banka nuk ruan ose transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një pasurie financiare dhe mban kontrollin mbi pasurinë, Banka vazhdon të njohë pasurinë deri në masën e përfshirjes së saj të vazhdueshme, të përcaktuar sipas masës për të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e pasurisë së transferuar.

Në transaksione të caktuara, Banka mban detyrimin për të shërbyer pasurinë financiare të transferuar duke ngarkuar një tarifë. Pasuritë e transferuara çregjistrohen nëse plotësojnë kriteret e çregjistrimit. Një pasuri ose detyrim njihet për kontratën e shërbimit, nëse tarifa e shërbimit është më shumë se e mjaftueshme (pasuri) ose është më e vogël se ajo e përshtatshme (detyrim) për kryerjen e shërbimit.

Detyrimet financiare

Banka ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale anulohen ose skadojnë.

(iv) Ndryshimet e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare

Pasuritë financiare

Nëse kushtet e një pasurie financiare ndryshohen, atëherë Banka vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare të pasurisë së modifikuar janë në thelb të ndryshme.

Nëse flukset e mjeteve monetare janë substancialisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale në flukset e mjeteve monetare nga pasuria financiare konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, pasuritë financiare origjinale ç'regjistrohen (shih (iii)) dhe një pasuri e re financiare njihet me vlerën e drejtë plus ndonjë kosto e pranueshme e transaksionit. Çdo tarifë e marrë si pjesë e modifikimit llogaritet si vijon:

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(iv) Ndryshimet e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

- Tarifat që konsiderohen në përcaktimin e vlerës së drejtë të pasurisë së re dhe tarifat që përfaqësojnë rimbursimin e kostove të pranueshme të transaksionit përfshihen në matjen fillestare të pasurisë; dhe
- Tarifat e tjera përfshihen në fitim ose humbje si pjesë e fitimit ose humbjes në çregjistrim.

Nëse flukset e mjeteve monetare ndryshohen kur huamarrësi është në vështirësi financiare, atëherë objektivi i modifikimit është zakonisht për të maksimizuar rikuperimin e kushteve kontraktuale origjinale në vend të emetimit të një pasurie të re me kushte thelbësisht të ndryshme. Nëse Banka ka në plan të modifikojë një pasuri financiare në një mënyrë që do të rezultonte me faljen e flukseve monetare, atëherë së pari duhet të konsiderojë nëse një pjesë e pasurisë duhet të shlyhet para se të bëhet modifikimi (shih më poshtë për politikën e zhvlerësimit). Kjo qasje ndikon në rezultatin e vlerësimit sasior dhe do të thotë që kriteret e çregjistrimit zakonisht nuk plotësohen në raste të tilla.

Nëse modifikimi i një pasurie financiare të matur me koston e amortizuar ose VDPHTGJ nuk rezulton në çregjistrimin e pasurisë financiare, atëherë Banka rillogaritë përsëri vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë dhe njeh rregullimin rezultues si një fitim ose humbje nga modifikimi në fitim ose humbje. Për pasuritë financiare me normë variabile, norma fillestare efektive e interesit e përdorur për të llogaritur fitimin ose humbjen e modifikimit rregullohet për të pasqyruar kushtet aktuale të tregut në kohën e modifikimit. Çdo shpenzim ose tarifë e kryer dhe tarifat e marra si pjesë e modifikimit rregullojnë vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare të modifikuar dhe amortizohen gjatë afatit të mbetur të aktivitetit financiar të modifikuar.

Nëse një ndryshim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih (vii)), atëherë fitimi ose humbja paraqiten së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhur nga interesi e llogaritur duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e saj ndryshohen dhe flukset monetare të detyrimit të modifikuar janë në thelb të ndryshme. Në këtë rast, një detyrim financiar i ri, bazuar në kushtet e modifikuara, njihet me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar të çregjistruar dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje. Shqyrtimi i paguar përfshin pasuritë jo financiare të transferuara, nëse ka, dhe supozimin e detyrimeve, duke përfshirë edhe detyrimin e ri financiar të modifikuar.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk llogaritet si çregjistrim, atëherë kosto e amortizuar e detyrimit rikalkulohet duke skontuar flukset e modifikuara të mjeteve monetare me normën fillestare të interesit efektiv, dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje. Për detyrimet financiare me normë variabile, norma fillestare efektive e interesit e përdorur për të llogaritur fitimin ose humbjen e modifikimit rregullohet për të pasqyruar kushtet aktuale të tregut në kohën e modifikimit. Çdo shpenzim dhe tarifë e përfshirë njihet si një rregullim në vlerën kontabël të detyrimit dhe amortizohet gjatë afatit të mbetur të detyrimit financiar të modifikuar duke riformuluar normën efektive të interesit në instrument.

(v) Netimi

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare thehen mes vete dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëhere dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtë të realizueshme ligjore për të shlyer shumat dhe ka për qëllim të shlyejë ato në baza neto ose realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohen sipas SNRF-ve, ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup transaksionesh të ngjashme siç është aktiviteti tregtar i Bankës.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

“Vlera e drejtë” është çmimi që do të ofrohej për të shitur një pasuri ose paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt në mes të pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në kryegjë ose, në mungesë të saj, tregu më i favorshëm në të cilin Banka ka çasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mosperformancës.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Kur të jetë në dispozicion, Banka matë vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet si 'aktiv' nëse transaksionet për pasuritë ose detyrimet zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në mënyrë të vazhdueshme.

Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknikën e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e përzgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është sigurisht çmimi i transaksionit – dmth vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një pasuri ose detyrim identik, e as nga teknika e vlerësimit për të cilën të dhënat e pavrojtueshme vlerësohen të jenë të parëndësishme në lidhje me matjen, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimin e transaksionit. Më pas, ky ndryshim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose kur transaksioni mbyllet.

Nëse një pasuri ose një detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim ofertimi dhe një çmim kërkimi, atëherë Banka matë pasuritë dhe pozicionet e gjata me një çmim të ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me një çmim kërkese.

Portofoliet e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare që janë të ekspozuara ndaj rrezikut të tregut dhe rrezikut të kredisë që menaxhohen nga Banka në bazë të ekspozimit neto ndaj rrezikut të tregut ose të kredisë, maten në bazë të një çmimi që do të merrej për të shitur një pozicion neto të gjatë (ose i paguar për të transferuar një pozicion neto të shkurtër) për ekspozimin e rrezikut të veçantë. Rregullimet në nivel të portofolit - p.sh. rregullimet e ofertës-kërkesës ose korrigjimet e rrezikut të kredisë që pasqyrojnë matjen në bazë të ekspozimit neto - alokohen në pasuritë dhe detyrimet individuale në bazë të rregullimit relativ të rrezikut të secilit instrument të veçantë në portofol.

Vlera e drejtë e një detyrimi financiar me një tipar kërkese (p.sh. një kërkesë depozitë) nuk është më e vogël se shumata e pagueshme sipas kërkesës, e skontuar nga data e parë në të cilën shumata mund të kërkohet të paguhet. Banka njih transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Rënia në vlerë

Banka njih lejimet për humbjet e pritshme kreditore (ECL) për instrumentet financiare të mëposhtme që nuk maten në VDPFH:

- Pasuritë financiare që janë instrumente borxhi;
- qeraja e arkëtueshme;
- kontratat e garancisë financiare të lëshuara; dhe
- zotimet e huasë të lëshuara.

Asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk njihet për investimet e kapitalit.

Banka matë lejimet e humbjeve në një shumë të barabartë me ECL-në përgjatë jetëgjatësisë, përveç për të mëposhtmet, për të cilën ato maten si ECL 12-mujore:

- letrat me vlerë të investimit të borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët të kredisë në datën e raportimit; dhe
- instrumente të tjera financiare (përveç qerasë së arkëtueshme) në të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja e tyre fillestare

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vii) Rënia në vlerë (vazhdim)

Lejimet e humbjeve për të arkëtueshmet e qerasë maten gjithmonë në një shumë të barabartë me ECL përgjatë jetëgjatësisë. Banka e konsideron investimin e borxhit që të ketë rrezik të ulët kreditor kur vlerësimi i rrezikut të saj të kredisë është i barabartë me përkufizimin e njohur botërisht të “klasës së investimeve”. Banka nuk zbaton përjashtimin e rrezikut të ulët të kredisë për çdo instrument financiar tjetër.

ECL 12-mujore janë pjesë e ECL që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit të pagimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Instrumentet financiare për të cilat një ECL 12 mujore është njohur, njihen si “Instrumente financiare të fazës 1”.

ECL përgjatë jetëgjatësisë janë ECL që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të dështimit të pagesës gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar. Instrumentet financiare për të cilat njihet ECL përgjatë jetëgjatësisë, por që nuk janë të dëmtuara nga aspekti kreditor, referohen si “Instrumentet Financiare të Fazës 2”.

Matja e ECL

ECL janë një vlerësim me probabilitet të ponderuar të humbjeve kreditore. Ato maten si më poshtë:

- *pasuritë financiare që nuk janë me rënie kreditore në datën e raportimit:* si vlera aktuale e të gjitha mjeteve monetare me rënie (p.sh diferenca midis flukseve të mjeteve monetare që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe fluksin e parasë që Banka pret të marrë);
- *pasuritë financiare që janë me rënie kreditore në datën e raportimit:* si diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të vlerësuar të flukseve të ardhshme monetare;
- *zotimet kreditore të pashfrytëzuara:* si vlera aktuale e diferencës midis flukseve monetare kontraktuale që i takojnë Bankës nëse kredia shfrytëzohet dhe flukseve të mjeteve monetare që Banka pret të marrë; dhe
- *kontratat e garancisë financiare:* pagesat e pritshme për të rimbursuar mbajtësin minus shumat që Banka pret të marrë.

Pasuritë financiare të ristrukturuara

Nëse kushtet e një pasurie financiare rinegocionohen ose modifikohen ose një pasuri financiare ekzistuese zëvendësohet me një të re për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë bëhet vlerësimi nëse pasuritë financiare duhet të ç’regjistrohen dhe ECL të matet si më poshtë.

- Nëse ristrukturimi i pritur nuk do të rezultojë në ç’regjistrimin e pasurisë ekzistuese, atëherë flukset e pritshme të mjeteve monetare që rrjedhin nga pasuria financiare e modifikuar përfshihen në llogaritjen e rënies së parasë nga pasuria ekzistuese.
- Nëse ristrukturimi i pritur do të rezultojë në ç’regjistrimin e pasurisë ekzistuese, atëherë vlera e drejtë e pritur e pasurisë së re trajtohet si fluksi i parave të gatshme nga pasuria financiare ekzistuese në kohën e ç’regjistrimit të saj. Kjo shumë përfshihet në llogaritjen e rënies së parasë nga pasuria financiare ekzistuese që skontohe nga data e pritur e ç’regjistrimit deri në datën e raportimit duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë financiare ekzistuese.

Pasuritë financiare me rënie kreditore

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse pasuritë financiare të mbartura me koston e amortizuar dhe pasuritë financiare të borxhit të mbartura në VDPHTGJ dhe të arkëtueshmet nga qeraja financiare, janë me rënie në vlerë kreditore (referuar si “Aktivet financiare të fazës 3”). Një pasuri financiare është “me rënie kreditore” kur ka ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset monetare të ardhshme të vlerësuar të pasurisë financiare.

Dëshmia se një pasuri financiare ka rënie në vlerë kreditore përfshinë të dhënat vijuese:

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vii) Rënia në vlerë (vazhdim)

- vështirësi të konsiderueshme financiare të huamarrësit ose emetuesit;
- shkelje e kontratës siç është dështim në pagesë ose ditë vonesa;
- ristrukturimi i një huaje ose avans nga Banka me kushte që Banka nuk do ta konsideronte përndryshe;
- është duke u bërë e dukshme që huamarrësi të hyjë në falimentim ose riorganizim tjetër financiar; ose
- zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë për shkak të vështirësive financiare.

Një hua që është rinegociuar për shkak të përkeqësimit të gjendjes së huamarrësit zakonisht konsiderohet të ketë rënie kreditore përveç nëse nuk ka dëshmi se rreziku i mosmarrjes së flukseve monetare kontraktuale është zvogëluar dukshëm dhe nuk ka indikatorë tjerë të rënies në vlerë. Gjithashtu, një kredi me ditë vonesa prej 90 ose më shumë ditë, konsiderohet të ketë rënie në vlerë edhe atëherë kur definicioni i rregullatorit për dështim në pagesë është tjetër.

Gjatë vlerësimit nëse një investim në borxh të huaj ka rënie në vlerë, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Vlerësimi i tregut për aftësinë kreditore, siç pasqyrohet në interesin e obligacioneve.
- Vlerësimet e agjencive të vlerësimit të aftësisë kreditore.
- Aftësia e vendit për të hyrë në tregjet e kapitalit për lëshimin e borxhit të ri.
- Mundësia e ristrukturimit të borxhit, duke rezultuar në humbje për mbajtësit nëpërmjet faljes vullnetare ose të detyrueshme të borxhit.
- Mekanizmat ndërkombëtarë të mbështetjes për të siguruar mbështetjen e nevojshme si "huadhënës i zgjidhjes së fundit" në atë vend, si dhe qëllimin e pasqyruar në deklaratat publike të qeverive dhe agjencive për përdorimin e këtyre mekanizmave. Kjo përfshin një vlerësim të thellësisë së këtyre mekanizmave dhe, pa marrë parasysh qëllimin politik, nëse ka kapacitet për të përmbushur kriteret e kërkuara.

Paraqitja e lejimit për ECL në pasqyrën e pozicionit financiar

Lejimet e humbjeve për ECL janë të prezantuara në pasqyrat financiare si në vijim:

- *aktivet financiare të matura me koston e amortizuar*: si zbritje nga vlera kontabël bruto e aktiveve;
- *zotimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare*: në përgjithësi si provizion;
- *kur një instrument financiar përfshin si një komponent të shfrytëzuar dhe një të pashfrytëzuar, dhe Banka nuk mund të identifikojë ECL-në për komponentin e kredisë ndaras nga ato në komponentin e shfrytëzuar*: Banka paraqet një lejim të humbjes së kombinuar për të dy komponentët. Shuma e kombinuar paraqitet si një zbritje nga vlera kontabël bruto e komponentit të shfrytëzuar. Çdo tejkallim i lejimit të humbjes mbi shumën bruto të komponentit të shfrytëzuar paraqitet si provizion; dhe
- *instrumentet e borxhit të matura në VDPHTGJ*: asnjë lejim për humbje nuk njihet në pasqyrën e pozicionit financiar sepse vlera kontabël e këtyre aktiveve është vlera e drejtë e tyre. Megjithatë, lejimi për humbje shpaloset dhe njihet në rezervën e vlerës së drejtë.

Shlyerjet

Kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit shlyhen (pjesërisht ose tërësisht) kur nuk ka pritje të arsyeshme për rikuperimin e një pasurie financiare në tërësinë ose një pjesë të saj. Kjo zakonisht ndodhë kur Banka përcakton se huamarrësi nuk ka asete ose burime të ardhurash që mund të gjenerojnë flukse të mjaftueshme të mjeteve monetare për të paguar shumat që i nënshtrohen shlyerjes. Ky vlerësim kryhet në nivelin individual të aseteve. Riarkëtimet e shumave të shlyera më parë janë përfshirë në "humbjet nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare" në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe HTGJ. Asetet financiare që janë shlyer, ende mund të jenë subjekt i veprimeve përbarimore në mënyrë që të jenë në përputhje me procedurat e Bankës për rikuperimin e shumave borxh.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vii) Rënia në vlerë (vazhdim)

Kontratat jo-integrale të garancisë financiare

Banka vlerëson nëse një kontratë e garancionit financiar është një element integral i një aktivi financiar që llogaritet si një komponent i atij instrumenti ose është një kontratë që llogaritet veçmas. Faktorët që Banka i konsideron kur bën këtë vlerësim përfshijnë nëse:

- garancioni është në mënyrë implicite pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit të borxhit;
- garancioni kërkohet nga ligjet dhe rregulloret që rregullojnë kontratën e instrumentit të borxhit;
- garancioni lidhet në të njëjtën kohë dhe në shqyrtimin e instrumentit të borxhit; dhe
- garancioni jepet nga prindi i huamarrësit ose një kompani tjetër brenda grupit të huamarrësit.

Nëse Banka përcakton se garancioni është një element integral i aktivitetit financiar, atëherë çdo premi e pagueshme në lidhje me njohjen fillestare të aktivitetit financiar trajtohet si një kosto e transaksionit për blerjen e tij. Banka e konsideron efektin e mbrojtjes gjatë matjes së vlerës së drejtë të instrumentit të borxhit dhe kur matet ECL. Nëse Banka përcakton se garancioni nuk është një element integral i instrumentit të borxhit, atëherë ajo njeh një pasuri që përfaqëson çdo parapagim të primit të garancionit dhe një të drejtë për kompensim nga humbjet kreditore. Një pasuri parapagim i primit njihet vetëm nëse ekspozimi i garantuar as nuk është me rënie kreditore dhe as nuk ka pësuar një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë kur jepet garancioni. Këto pasuri njihen në 'pasuri të tjera'. Banka paraqet fitim ose humbje në të drejtën e kompensimit në fitim ose humbje në zërin 'humbjet nga zhvlerësimi i instrumenteve financiarë'.

(h) Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë monedha dhe kartëmonedha në arkë, balanca në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorim dhe aktive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj ose më pak nga data e blerjes e të cilat kanë rrezik të ulët të ndryshimit në vlerën e tregut të tyre, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e zotimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen me kosto të amortizuara.

(i) Kreditë dhe paradhëniet

“Kreditë dhe paradhëniet” në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë:

- huatë dhe paradhëniet e matura me koston e amortizuar; ato fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte shtesë të transaksionit dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv;
- huatë dhe paradhëniet e matura në mënyrë të detyrueshme në VDPFH ose të përcaktuara si në VDPFH (shih J (ii)); këto maten me vlerën e drejtë me ndryshimet e njohura menjëherë në fitim ose humbje; dhe
- Llogaritë financiare të arkëtueshme

Kur Banka blen një pasuri financiare dhe në të njëjtën kohë hyn në një marrëveshje për të rishitur pasurinë (ose një pasuri të ngjajshme) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo e kundërt ose huamarrja e stokut), marrëveshja llogaritet si një hua ose paradhënie, dhe asetit themelor nuk njihet në pasqyrat financiare të Bankës..

(j) Investimet në letra me vlerë

“Investimet në letra me vlerë” në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë:

- letrat me vlerë të borxhit të matura në VDPHTGJ

Për titujt e borxhit të matur në VDPHTGJ, fitimet dhe humbjet njihen në HTGJ përveç për të mëposhtmet, të cilat njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar:

- të ardhurat nga interesi duke përdorur metodën e interesit efektiv;
- ECL dhe pezullimet; dhe
- fitimet dhe humbjet në valutë të huaj.

Kur instrumentet e borxhit të matur në VDPHTGJ ç’regjistrohen, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në HTGJ riklasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet janë paraqitur me kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar dhe rënia në vlerë e akumuluar, nëse ka. Kostoja historike përfshin shpenzimet që i atribuohen drejtpërsëdrejtë blerjes së zërave të pronës dhe pajisjeve.

Shpenzimet pasuese përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me artikullin do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e artikullit mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i ngarkohen shpenzimeve të tjera operative gjatë periudhës financiare në të cilën ato kanë ndodhur.

Vlera kontabël e pronës dhe pajisjeve rishikohet për rënie në vlerë kur ngjarjet ndryshojnë ose ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekzistojnë indikacione të tilla dhe ku vlerat kontabël tejkalojnë shumën e vlerësuar si të rikuperueshme, pasuritë ose njësitë gjeneruese të mjeteve monetare regjistrohen me shumën e tyre të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e pronës dhe pajisjeve është shuma më e madhe në mes të vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme të vlerësuar zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike për pasuritë.

Për një pasuri që nuk gjeneron flukse monetare kryesisht të pavarura, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përket pasuria. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Toka dhe pasuritë në ndërtim e sipër nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i pasurive ngarkohet në bazë të metodës lineare me normat e përcaktuara për shpërndarjen e kostos së pronës dhe pajisjeve përgjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Normat vjetore të zhvlerësimit përcaktohen nga jetëgjatësia e vlerësuar e pasurive të caktuara siç paraqitet më poshtë:

Përshkrimi	Jetëgjatësia 2020	Jetëgjatësia 2019
Ndërtesat	40 vite	40 vite
Investimet në objektet e mara me qira	Bazuar në afatin e qirasë	Bazuar në afatin e qirasë
Toka nuk zhvlerësohet		
Pajisjet elektronike	2-5 vite	2-5 vite
Mobiljet dhe instalimet	5-10 vite	5-10 vite
Automjetet motorike	3-5 vite	3-5 vite
Pasuritë tjera fikse	2-10 vite	2-10 vite

Prona dhe pajisjet me jetë të dobishme më shumë se një vit që bien nën pragun e materialitetit prej 100 Euro (2019: 100 Euro) dhe gjithashtu që nuk janë materiale në tërësi, regjistrohen si shpenzime në fitim ose humbje.

Fitimet dhe humbjet nga hedhja jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël neto. Këto janë të përfshira në të ardhurat tjera ose shpenzime tjera operative (sipas rastit) në fitim ose humbje.

(l) Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme njihen nëse është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që i atribuohen pasurisë do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e pasurisë mund të matet në mënyrë të besueshme. Pasuritë e paprekshme maten fillimisht me kosto. Vlera kontabël e pasurive të paprekshme shqyrtohet për rënie në vlerë kur ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Pasuritë e paprekshme përbëhen tërësisht nga softueri kompjuterik, i cili amortizohet duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së vlerësuar prej pesë vitesh, nëse nuk ceket ndryshe në kontratën korresponduese.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(m) Kolaterali i marrë në pronësi

Kolaterali i marrë në pronësi përfaqëson pronat e marrura nga Banka në zgjidhjen e kredive në vonesë. Këto pasuri njihen fillimisht me vlerën më të ulët në mes të vlerës së drejtë minus kosto e shitjes dhe vlerës kontabël të kredisë në datën e këmbimit. Kolaterali i luajtshëm nuk njihet si një pasuri kur merret në pronësi.

Më pas, Banka matë kolateralin e marrë në pronësi me vlerën më të ulët në mes të vlerës së njohur fillimisht dhe vlerës së drejtë të pronave minus kostot e shitjes. Për vlerësimin e vlerës së drejtë, menaxhmenti përdorë vlerësimin e kryer nga vlerësuesit ekspertë të jashtëm, të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës. Banka ka aplikuar përqindje zhvlerësimi të përcaktuara nga Banka që pasqyrojnë kufizimet e tregut, shqyrtimin e vlerës kohore të parasë dhe çështjeve ligjore me pronat.

Menaxhmenti i Bankës ka vlerësuar 20% si përqindje të zhvlerësimit fillestar në vlerën e drejtë që përfaqëson më së miri kufizimet e mësipërme. Përqindjet e zhvlerësimit shtesë aplikohen për të pasqyruar çështjet ligjore dhe vështirësitë shtesë për të realizuar shitjen. Pasuritë e riposeduara shlyhen në rast se ato nuk janë shitur nga Banka 3 vite pas riposedimit. Çdo humbje që rrjedhë nga rivlerësimi i mësipërm regjistrohet në fitim ose humbje. Fitimet ose humbjet nga shitja e këtyre pasurive njihen në fitim ose humbje.

(n) Të arkëtueshmet nga bankat tjera

Shumat e arkëtueshme nga bankat e tjera regjistrohen kur Banka u parapaguan bankave të tjera pa pasur si synim tregtimin e të arkëtueshmeve jo-derivative të pakuotuar që rezultojnë në datat fikse ose të përcaktueshme. Shumat e arkëtueshme nga bankat e tjera mbarten me koston e amortizuar.

(o) Depozitat dhe detyrimet e varura

Depozitat dhe detyrimet e varura janë burimet kryesore të borxhit për financimin e Bankës.

Kur Banka shet një pasuri financiare dhe në të njëjtën kohë hyn në një marrëveshje për të riblerë atë pasuri (ose një pasuri të ngjashme) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (marrëveshja e shitjes dhe e riblerjes), marrëveshja llogaritet si një depozitë dhe paurita vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat dhe detyrimet e varura fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot shtesë të drejtëpërdrejta të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(p) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Banka ka një detyrim aktual ose konstruktiv që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke zbritur flukset monetare të ardhshme të pritshme me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Zbërthimi i zbritjes njihet si kosto financiare.

(q) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet në planin e pensioneve të administruara publikisht në baza të detyrueshme. Banka nuk ka detyrime të mëtejshme të pagesës pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihen si shpenzime për përfitimet e punonjësve kur ato duhet të paguhet. Banka ka llogaritur dhe ofruar provizion për pushimin e pashfrytëzuar të stafit nga fundi i periudhës raportuese.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(r) Garancionet financiare dhe zotimet e huasë

“Garancionet financiare” janë kontrata që kërkojnë nga Banka që të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për humbjen që shkaktohet sepse një debitor specifik nuk arrin të bëjë pagesën kur ajo është e aplikueshme në përputhje me kushtet e një instrumenti borxhi. Zotimet e kredisë janë angazhime të sigurta për të ofruar kredi sipas afateve dhe kushteve të paracaktuara.

Garancionet financiare të lëshuara ose zotimet për të siguruar një hua me një normë interesi nën nivelin e tregut fillimisht maten me vlerën e drejtë. Më pas, ato maten si më poshtë:

- Në masën më të lartë të lejimit të humbjes të përcaktuar në përputhje me SNK 37 dhe shumën e njohur fillimisht minus, kur është e përshtatshme, shumën kumulative të të ardhurave të njohura në përputhje me parimet e SNRF 15

Banka nuk ka dhënë asnjë zotim huaje që matet në VDPFH.

Për zotimet e tjera të huasë:

- Banka njeh lejim për humbje në përputhje me SNRF 9

Detyrimet që rrjedhin nga garancionet financiare dhe zotimet e huasë përfshihen në provizione.

(s) Kapitali aksionar

(i) Shpenzimet e emetimit të aksioneve

Kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejtë emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje, neto nga tatimi, nga të ardhurat.

(ii) Primi i aksioneve

Primi i aksioneve përfaqëson tejkalimin e kontributit të marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara.

(iii) Dividendët për aksionet e zakonshme

Dividendët për aksionet e zakonshme njihen në kapitali në periudhën në të cilën ato janë miratuar nga aksionerët e Bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit shpalosen si ngjarje pas përfundimit të periudhës raportuese.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Në vijim ndryshimet e reja të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (BNSK) janë efektive për periudhën aktuale të raportimit:

- **Ndryshimet në SNRF 3 “Kombinimet e Biznesit”** - Përkufizimi i një biznesi (efektiv për kombinimet e biznesit për të cilin data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e pasurive që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).
- **Ndryshimet në SNRF 9 “Instrumentet Financiare”, SNK 39 “Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja” and SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Shpalesje”** – Reforma në normën referente të interesit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020),
- **Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” dhe SNK 8 “Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet”**- Përkufizimi i Materialitetit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020),
- **Ndryshimet në Referencat e Kornizës Konceptuale në Standardet e SNRF-ve** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020),
- **Ndryshimet në SNRF 16 “Qiratë”** - Koncesionet e qirave që lidhen me Covid-19 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Qershorit 2020).

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk kanë çuar në ndryshim material të zërave të Bankës.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (vazhdim)

3.2. Standardet dhe interpretimet që nuk janë ende efektive

Këto standarde dhe interpretime që janë lëshuar, por nuk janë ende efektive deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Bankës, janë shpalosur si vijon. Banka ka për synim të adaptojë këto standarde, nëse janë të aplikueshme, në momentin që hyjnë në fuqi.

- **SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit”** duke përfshirë ndryshimet në SNRF 17 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),
- **Ndryshimet në SNRF 3 “Kombinimet e Biznesit”** – Referencë e Kornizës Konceptuale me ndryshimet në SNRF 3 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022)
- **Ndryshimet në SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit”** - Zgjatja e Përfundimit të Përkohshëm nga Zbatimi i SNRF 9 (data e skadimit të përfundimit të përkohshëm nga SNRF 9 është shtyrë për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023),
- **Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta”** - Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri sa projekti hulumtues në metodologjinë e kapitalit të përfundohet),
- **Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”** – Klasifikimi i detyrimeve në afatshkurtëra dhe afatgjata (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023),
- **Ndryshimet në SNK 16 “Prona, impiantet dhe pajisjet”** – Të ardhurat para përdorimit të synuar (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022),
- **Ndryshimet në SNK 37 “Provizionet, Detyrimet Kontigjente dhe Pasuritë Kontigjente”** - Kontratat e ndryshueshme — Kostoja e Përbushjes së Kontratës (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022),
- **Ndryshimet në SNRF 9 “Instrumentet Financiare”, SNK 39 “Instrumentet: Njohja dhe Matja”, SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Shpalosjet”, SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit” dhe SNRF 16 “Qiratë”** - Reforma në norën referente të interesit — Faza 2 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2021),
- **Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të “Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2018 -2020)”** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit (ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNK 41 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).

Banka ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Banka parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve (përveq SNRF 16 siç paraqitet më poshtë) nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat e veçanta financiare të bankës në periudhën aplikimit fillestar.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. Gjykime kritike kontabël dhe burimet kyç të vlerësimit të pasigurisë

Banka bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet mbi ngjarjet e ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave.

(a) Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit

Informacioni mbi supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material në vitet pasuese është dhënë më poshtë në lidhje me rënien në vlerë të instrumenteve financiare.

(i) Ngarkesa për rënien në vlerë për humbjet nga kreditë

Banka shqyrton portofolet e saj të huave për të vlerësuar zhvlerësimin në baza mujore për ekspozimet kreditore në bilanc dhe jashtë bilanci, pa marrë parasysh madhësinë e tyre. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Banka bën gjykime nëse ka të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një ulje të matshme në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara nga një portofol kredish para se të mund të identifikohet rënia me një hua individuale në atë portofol. Kjo dëshmi mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagesave të huamarrësve në një grup, ose kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që lidhen me mospagimin e pasurive në Bankë.

Menaxhmenti përdor vlerësime bazuar në përvojën historike të humbjes për aktivet me karakteristika të riskut të kredisë dhe dëshmi objektive të zhvlerësimit të ngjashëm me ato të portofolit gjatë caktimit të flukseve monetare të ardhshme. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të zvogëluar çdo diferencë midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës aktuale të humbjes.

Një rritje ose ulje prej 10% në përvojën aktuale të humbjes në krahasim me vlerësimet e humbura do të rezultojë në një rritje ose ulje në zhvlerësimin e huave dhe paradhënieve për 1,673 mijë euro (2019: 1,431 mijë euro). Humbjet nga zhvlerësimi për kredi të mëdha individuale bazohen në vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme të skontuara të kredive individuale, duke marrë parasysh ripagesat dhe realizimin e çdo aktivi të mbajtur si kolateral kundrejt huave. Rritja ose zvogëlimi i përvojës aktuale të humbjes prej 10% në krahasim me flukset monetare të ardhshme të skontuara të parashikuara nga kreditë me vlerë të konsiderueshme, të cilat mund të lindin nga diferencat në shumat dhe kohën e flukseve të mjeteve monetare, do të rezultojnë në një rritje ose ulje të zhvlerësimit të huave dhe paradhënieve për 201 mijë euro (2019: 101 mijë euro), respektivisht.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar

Aktivitetet e Bankës e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie risqesh dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e një shkalle risku ose kombinimi të risqeve. Marrja e riskut është thelbësore për biznesin financiar dhe risqet operationale janë një pasojë e pashmangshme e të qenurit në biznes. Qëllimi i Bankës është, pra, të arrijë një ekuilibër të përshtatshëm midis riskut dhe kthimit dhe të minimizojë efektet e mundshme negative në ecurinë financiare të Bankës.

Politikat e menaxhimit të riskut të Bankës janë të dizajnuara për të identifikuar dhe analizuar këto risqe, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e duhura të riskut si dhe për të monitoruar risqet dhe respektuar kufizimet nëpërmjet sistemeve të besueshme dhe të përditësuara të informacionit. Banka rregullisht shqyrton politikat dhe sistemet e saj të menaxhimit të riskut për të pasqyruar ndryshimet në tregjet, produktet dhe praktikat më të mira në zhvillim.

Menaxhimi i riskut kryhet kryesisht nga Funkzioni i Monitorimit të Riskut dhe Departamenti i Riskut të Kredisë që punojnë sipas politikave të administrimit të riskut të miratuara nga Bordi i Drejtorëve. Bordi ofron parime të shkruara për menaxhimin e përgjithshëm të riskut, si dhe politikat me shkrim që mbulojnë fusha specifike, të tilla si, risku i kredisë, risku i kursit të këmbimit, risku i normës së interesit dhe risku i likuiditetit. Përveç kësaj, auditimi i brendshëm është përgjegjës për rishikimin e pavarur të menaxhimit të riskut dhe mjedisit të kontrollit.

(a) Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si normat e valutave të huaja, normat e interesit, çmimet e kapitalit dhe diferencat e kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në pozicionin e kreditorit / emetuesit) do të ndikojnë në të ardhurat e Bankës ose në vlerën e zotërimeve të saj të instrumenteve financiare. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin në rrezik.

(i) Risku i valutës së huaj

Risku i valutës është risku që vlera e një instrumenti financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor. Banka synon të mos përfitojë nga ndonjë transaksion spekulativ, ajo përpiqet të mbajë pozicionin e saj të hapur ndaj valutave të huaja në afërsi të zeros gjatë gjithë kohës. Kufijtë e pozicionit të hapur të valutës dhe kapaciteti për marrjen e riskut për Bankën përcaktohen nga politikat përkatëse, të cilat miratohen nga Bordi i Drejtorëve dhe shqyrtohen nga Funkzioni i Monitorimit të Riskut. Kufijtë e rregullatorit në çdo kohë respektohen nga Banka.

Njësia e Thesarit vlerëson zhvillimet e kursit të këmbimit në lidhje me të gjitha pozicionet valutore materiale. Ndryshimet e mëdha në strukturën e pasurive dhe detyrimeve të shprehura në valutë të huaj dhe impakti i tyre rishikohen para se të realizohen tregtime nga departamenti i zyrës së thesarit të bankës.

Njësia e Thesarit gjithashtu vëzhgon tregun financiar dhe informon Funkzionin e Monitorimit të Riskut rregullisht dhe në rast të zhvillimeve të rëndësishme që mund të ndikojnë në gjendjen e riskut të valutës së Bankës.

Edhe pse Banka synon të mbajë pozicionin e saj të valutës sa të jetë e mundur më afër zeros, mund të ketë raste kur Banka ende ndikohet nga paqëndrueshmëria e paparashikuar e kursit të këmbimit. Prandaj, Funkzioni i Monitorimit të Riskut kryen teste të stresit dhe raporton efektet në Fitimin ose Humbjen e Bankës në baza mujore. Normat zyrtare të këmbimit për valutat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit të shprehur në monedha të huaja ishin si më poshtë (në euro):

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
1 dollar amerikan	0.8149	0.8901
1 frang zviceran	0.9258	0.9213
1 paund britanik	1.1123	1.1753

Tabelat në vijim përmbledhin pasuritë dhe detyrimet financiare të Bankës në valutë të huaj më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, të konvertuara në mijë euro.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(i) Risku i valutës së huaj (vazhdim)

31 dhjetor 2020	EUR	USD	CHF	GBP	Total
Pasuritë					
Balancat me Bankat Qendrore	261,576	1,301	187	12	263,076
Kreditë dhe paradhëniet për banka	22,735	16,810	270	100	39,916
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	514,254	-	-	-	514,254
Investimet në letrat me vlerë të matura në VDPHTGJ	51,750	13,205	-	-	64,955
Pasuritë tjera financiare	1,320	531	-	-	1,851
Gjithsej pasuritë financiare monetare	851,635	31,847	457	112	884,051

Detyrimet

Detyrimet ndaj bankave tjera	607	-	1	-	608
Detyrimet ndaj klientëve	717,005	32,433	339	21	749,798
Huamarrjet dhe borxhi i varur	32,518	-	-	-	32,518
Detyrimet tjera financiare	1,248	-	-	1	1,249
Gjithsej detyrime monetare financiare	751,378	32,433	340	22	784,173
Pozicioni financiar bilancor neto	100,258	(585)	117	90	99,878
Zotimet e kredive	69,171	4	-	-	69,175
Zërat jashtë-bilancor – letrat e kreditit	35	41	-	-	76
Zërat jashtë-bilancor – garancionet bankare	33,549	489	-	-	34,038
Gjithsej zotimet kreditore	102,755	534	-	-	103,289

31 dhjetor 2019

	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Pasuritë					
Balancat me Bankat Qendrore	156,147	1,568	217	13	157,945
Kreditë dhe paradhëniet për banka	26,945	13,560	185	20	40,710
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	504,450	810	-	-	505,260
Investimet në letrat me vlerë të matura në VDPHTGJ	74,854	12,145	-	-	86,999
Pasuritë tjera financiare	1,740	579	-	-	2,319
Gjithsej pasuritë financiare monetare	764,136	28,662	402	33	793,233

Detyrimet

Detyrimet ndaj bankave tjera	714	-	1	-	715
Detyrimet ndaj klientëve	644,214	28,566	297	36	673,113
Huamarrjet dhe borxhi i varur	27,444	-	-	-	27,444
Detyrimet tjera financiare	1,436	-	-	-	1,436
Gjithsej detyrime monetare financiare	673,807	28,566	298	36	702,707
Pozicioni financiar bilancor neto	90,329	95	104	(3)	90,525
Zotimet e kredive	58,183	87	-	-	58,270
Zërat jashtë-bilancor – letrat e kreditit	213	-	-	-	213
Zërat jashtë-bilancor – garancionet bankare	35,709	578	-	-	36,287
Gjithsej zotimet kreditore	94,105	665	-	-	94,770

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(i) Risku i valutës së huaj (vazhdim)

Tabela më poshtë përmbledhë analizën e ndjeshmërisë për riskun e valutës së huaj dhe efektin mbi fitimin ose humbjen dhe kapitalin neto të Bankës, neto nga tatimi:

	Rritja 2020	Rritja 2019	Efekti mbi fitimin ose humbjen dhe kapitalin neto	
			31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Dollarë amerikan	10%	10%	56	8
Të tjera	10%	10%	21	9

(ii) Risku i normës së interesit

Banka është e ekspozuar ndaj risqeve të ndryshme që lidhen me efektet e luhatjeve të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe flukset e mjeteve monetare. ProCredit Bank nuk synon të përfitojë nëpërmjet transformimit të maturitetit të tepërt, ose formave të tjera të spekulimeve në tregun e normave të interesit. Përkundrazi, Banka synon të sigurojë që struktura e pasurive dhe detyrimeve të jetë e balancuar në të gjitha maturitetet.

Menaxhimi i riskut të normës së interesit të Bankës është në përputhje me Basel II, duke marrë parasysh që norma e interesit është e ndjeshme vetëm ndaj kryegjësë (vlera nominale); ndryshimet e përlllogaritura dhe në vlerën e drejtë konsiderohen si jo të ndjeshme ndaj normës të interesit.

Tabelat e mëposhtme përmbledhin ekspozimin e Bankës ndaj risqeve të normës së interesit. Të përfshira në tabela janë pasuritë dhe detyrimet financiare të Bankës me norma interesi fikse dhe jo-fikse.

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në euro Më 31 dhjetor 2020	Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vite	2-5 vite	Më shumë 5 vite	Gjithsej interesi i ndjeshëm	Interesi jo ndjeshëm
Pasuritë								
Paraja e gatshme	-	-	-	-	-	-	-	49,429
Balancat me Bankën Qendrore	169,278	-	-	-	-	-	169,278	43,067
Llogaritë rrjedhëse me bankat	11,872	-	-	-	-	-	11,872	(2)
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme	Fikse 2,000 Variable -	500 10,000	23,550	4,820	9,690	-	40,560	812 378
Depozitat me afat në banka	-	8,748	1,265	1,220	4	-	11,236	(1)
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Fikse 37,408 Variable 106,905	82,395	107,360	83,156	86,093	8,995	405,407	1,943
Pasuritë tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	1,320
Gjithsej pasuritë	327,463	101,642	132,175	89,196	95,787	8,995	755,258	96,946
Detyrimet								
Llogaritë rrjedhëse nga bankat	-	-	-	-	-	-	-	608
Llogaritë rrjedhëse nga klientët	6,600	33,001	39,601	79,202	-	-	158,403	453,906
Depozitat nga klientët	3,438	24,140	32,983	28,709	5,987	-	95,257	1,340
Huamarrjet dhe borxhi i varur	Fikse 2,143 Variable -	-	2,143	12,286	8,429	-	25,000	(19)
Detyrimet tjera financiare	-	-	-	-	7,500	-	7,500	37
	-	-	-	-	-	-	-	1,248
Gjithsej detyrimet	12,181	57,141	74,727	120,196	21,915	-	286,160	457,119
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj NI - pozicioni i hapur	315,282	44,502	57,448	(31,000)	73,872	8,995	469,098	n/a

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interesit (vazhdim)

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në euro Më 31 dhjetor 2019	Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 Vite	2-5 vite	Më shumë 5 vite	Gjithsej interesi i ndjeshëm	Interesi jo i ndjeshëm
Pasuritë								
Paraja e gatshme	-	-	-	-	-	-	-	41,433
Balancat me Bankat Qendrore	77,214	-	-	-	-	-	77,214	37,730
Llogaritë rrjedhëse me bankat	2,778	-	-	-	-	-	2,778	530
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme	Fikse 1,750 Variable 28,000	2,280 5,000	26,050	6,050	4,460	100	40,690	1,115
Depozitat me afat në banka	117	20,386	2,561	400	390	-	23,854	(11)
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Fikse 37,065 Variable 85,418	92,054	100,316	84,403	93,845	9,604	417,287	1,701
Pasuritë tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	1,740
Gjithsej pasuritë	232,342	119,720	128,927	90,853	98,695	9,704	680,241	84,287
Detyrimet								
Llogaritë rrjedhëse me bankat	-	-	-	-	-	-	-	715
Llogaritë rrjedhëse nga klientët	5,712	28,505	34,207	68,413	-	-	136,837	403,377
Depozitat nga klientët	2,958	11,184	31,016	29,564	28,333	-	103,055	1,347
Huamarrjet dhe borxhi i varur	Fikse - Variable -	-	-	2,857	17,143	-	20,000	(94)
Detyrimet tjera financiare	-	-	-	-	7,500	-	7,500	38
Gjithsej detyrimet	8,670	39,689	65,223	100,834	52,976	-	267,392	406,819
Hendeku i ndjeshmërisë NI - pozicioni i hapur	223,672	80,031	63,704	(9,981)	45,719	9,704	412,849	n/a

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interesit (vazhdim)

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në USD Më 31 dhjetor 2020	Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 Vite	2-5 Vite	Gjithsej interesi i ndjeshëm	Interesi jo i ndjeshëm
Paraja e gatshme	-	-	-	-	-	-	1,301
Llogaritë rrjedhëse me bankat	6,382	-	-	-	-	6,382	647
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme	Fikse 3,260	3,260	6,519	-	-	13,039	166
	Variable	-	-	-	-	-	-
Depozitat me afat në banka	4,075	5,705	-	-	-	9,779	534
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Fikse	-	-	-	-	-	-
Pasuritë tjera financiare	-	-	-	-	-	-	531
Gjithsej pasuritë	13,716	8,964	6,519	-	-	29,200	3,180
Llogaritë rrjedhëse nga klientët	6,481	-	-	-	-	6,481	25,857
Depozitat nga klientët	2	-	93	-	-	95	-
Detyrimet tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej detyrimet	6,483	0	93	-	-	6,576	25,857
Hendeku i ndjeshmërisë NI - pozicioni i hapur	7,233	8,964	6,427	-	-	22,624	n/a

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në USD Më 31 dhjetor 2019	Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 Vite	2-5 Vite	Gjithsej interesi i ndjeshëm	Interesi jo i ndjeshëm
Paraja e gatshme	-	-	-	-	-	-	1,568
Llogaritë rrjedhëse me bankat	4,357	-	-	-	-	4,357	-
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme	Fikse -	7,121	-	-	-	7,121	115
	Variable	4,896	-	-	-	4,896	13
Depozitat me afat në banka	1,780	7,388	-	-	-	9,168	614
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Fikse	-	783	71	-	854	-
Pasuritë tjera financiare	-	-	-	-	-	-	579
Gjithsej pasuritë	11,033	15,292	71	-	-	26,396	2,889
Llogaritë rrjedhëse nga klientët	7,041	-	-	-	-	7,041	21,422
Depozitat nga klientët	2	-	101	-	-	103	-
Detyrimet tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej detyrimet	7,043	0	101	-	-	7,144	21,422
Hendeku i ndjeshmërisë NI - pozicioni i hapur	3,990	15,292	(31)	-	-	19,252	n/a

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interesit (vazhdim)

Analiza dhe llogaritjet bëhen për të përcaktuar efektin në lëvizjet e normave të interesit në vlerën ekonomike të kapitalit dhe të kapaciteteve të fitimit të interesit gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe rrjedhimisht për të zbutur risqet që ndikojnë në këto dy parametra. Duke konsideruar strukturat e pasurive dhe detyrimeve në euro dhe dollar amerikan më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, si dhe duke supozuar një zhvendosje paralele të normës së interesit për +/- 50 pikë përqindje në pasuritë dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normës, është paraqitur më poshtë profili i riskut të normës së interesit të Bankës, ku vlerat negative përfaqësojnë humbjet dhe uljen e kapitalit neto:

Rritja në normën e interesit për 0.5%	Rënia e fitimit të interesit gjatë 3 muajve të ardhshëm		Rënia e fitimit të interesit gjatë vitit të ardhshëm		Ndikimi i Vlerës Ekonomike	
	2020	2019	2020	2019	2020	2019
<i>Pasuritë dhe detyrimet në:</i>						
Euro	345	252	1,770	1,464	(1,374)	(1,289)
Dollar amerikan	10	8	76	77	(35)	(19)

(b) Risku i kredisë

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj riskut të kredisë, i cili është risku që pala tjetër të shkaktojë një humbje financiare për Bankën duke mos përmbushur një detyrim. Risku i kredisë është i përhapur në biznesin e Bankës; prandaj menaxhmenti menaxhon me kujdes ekspozimin ndaj riskut të kredisë. Ekspozimet e kredive lindin kryesisht në aktivitetet huadhënëse që çojnë në kreditë dhe paradhëniet si dhe aktivitetet e investimit që sjellin vendosje dhe letra me vlerë të borxhit në portfolion e pasurive të Bankës.

Ekziston edhe risku i kredisë në instrumentet financiare jashtë bilancore, siç janë letrat e kreditit, garancionet dhe zotimet e kredisë. Menaxhimi dhe kontrolli i riskut të kredisë për kreditë dhe paradhëniet janë të centralizuara në departamentin e menaxhimit të riskut të kredisë, ndërkohë që risku ndërbankar për vendosjet dhe letrat me vlerë të borxhit janë të përqendruara në departamentet e Thesarit dhe të Menaxhimit të Riskut. Të gjitha departamentet përgjegjëse për administrimin dhe kontrollin e riskut të kredisë, raportojnë rregullisht në Bordin Menaxhues dhe në Bordin e Drejtorëve.

(i) Analiza e cilësisë së kredisë

Tabelat e mëposhtme paraqesin informacionin në lidhje me cilësinë kreditore të pasurive financiare dhe lejimin për rënien në vlerë/ humbjen e mbajtur nga Banka kundrejt këtyre pasurive.

Tabela përfaqëson skenarin më të keq të rastit të ekspozimit ndaj riskut të kredisë të Bankës më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, pa marrë parasysh ndonjë kolateral të mbajtur ose përmirësime të tjera të bashkangjitura të kredisë. Për pasuritë financiare, ekspozimet e paraqitura më poshtë paraqesin vlerën kontabël neto të raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Vlera kontabël	Vlera e zotuar/ garantuar	Vlera kontabël	Vlera e zotuar/ garantuar
Balancat me bankat qendrore	212,346	-	114,944	-
Kreditë dhe paradhëniet për banka	39,916	-	40,710	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	514,254	-	505,260	-
Investime në letrat me vlerë të matura në VDPHTGJ	64,955	-	86,999	-
Pasuritë tjera financiare	1,851	-	2,319	-
Zotimet dhe garancionet e huadhënies	-	103,289	-	94,770
Gjithsej	833,322	103,289	750,232	94,770

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Zërat jashtë-bilancor	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Zotimet e kredisë	69,175	58,270
Garancionet financiare	26,305	28,335
Garancionet jo-financiare	7,733	7,952
Letrat e kreditit	76	213
	103,289	94,770
Provizionet e njohura si detyrime	(738)	(453)
Gjithsej	102,551	94,317

Paraja dhe balancat me bankat qendrore

Paraja dhe llogaria rrjedhëse me bankat nuk janë në vonesë, dhe as me rënie në vlerë dhe nuk janë të kolateralizuara. Cilësia kreditore e parasë së gatshme dhe balancave me bankat qendrore është dhënë më poshtë. Bankës Qendrore të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës nuk u ofrohet një vlerësim nga agjencitë e njohura të vlerësimit.

	Vlerësimi nga Fitch	Balancat e parasë me bankat qendrore, duke përfshirë rezervat e detyrueshme	Letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës me maturitet më pak se 3 muaj	Gjithsej
<i>Në mijëra Euro</i>				
31 dhjetor 2020				
<i>Pa vonesë dhe pa rënie në vlerë:</i>				
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	nuk është vlerësuar			
- Llogaritë rrjedhëse		20,203	-	20,203
- Rezerva e detyrueshme		43,067	-	43,067
- Letrat me vlerë qeveritare		-	2,015	2,015
Banka Qendrore e Republikës së Gjermanisë (Deutsche Bundesbank)	AAA	149,075	-	149,075
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë, duke përjashtuar paranë në arkë		212,346	2,015	214,360
	Vlerësimi nga Fitch	Balancat e parasë me bankat qendrore, duke përfshirë rezervat e detyrueshme	Letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës me maturitet më pak se 3 muaj	Gjithsej
<i>Në mijëra Euro</i>				
31 dhjetor 2019				
<i>Pa vonesë dhe pa rënie në vlerë:</i>				
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	nuk është vlerësuar			
- Llogaritë rrjedhëse		18,192	-	18,192
- Rezerva e detyrueshme		37,730	-	37,730
- Letrat me vlerë qeveritare		-	2,006	2,006
Banka Qendrore e Republikës së Gjermanisë (Deutsche Bundesbank)	AAA	59,022	-	59,022
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë, duke përjashtuar paranë në arkë		114,944	2,006	116,950

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shummat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Detyrimet nga bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë përmes njësisë së monitorimit të riskut dhe njësisë së thesarit. Banka kufizon depozitat dhe transaksionet e tjera bankare në bankat ndërkombëtare me gjendje financiare të shëndoshë. Para se të fillohet një marrëdhënie biznesi me një bankë të caktuar, menaxhmenti i Bankës dhe njësia e monitorimit të riskut kryejnë një analizë mbi gjendjen financiare të institucionit. Përformanca financiare e palëve kontraktuese monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korresponduese, si dhe emetuesit e bonove në të cilat Banka ka ekspozime investimi, monitorohen vazhdimisht për vlerësimet e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Standard & Poor's (S&P), Fitch dhe Moody's. Funksioni i pavarur nga njësia e thesarit, njësia e monitorimit të riskut, monitoron që ekspozimi ndaj të gjitha bankave të mos tejkaloj kufijtë rregullatorë ose kufijtë e brendshëm të përcaktuar nga menaxhmenti i Bankës. Kështu, njësia e monitorimit të riskut mbështet njësinë e thesarit duke ofruar raporte që tregojnë ekspozimet dhe vendosjet që mund të bëhen për të gjitha bankat korresponduese pa shkelur kufijtë e tanishëm të ekspozimit.

Në pajtim me rregulloren e re për ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ndonjë ekspozim të përgjithshëm të riskut të kredisë ndaj palëve të ndërlidhura që tejkalojnë 15% të kapitalit rregullator të nivelit të parë. Për më tepër, për të reduktuar më tej riskun nga palët e tjera, komiteti i pasurive dhe detyrimeve (ALCO) miratoi limitet e brendshme për ekspozimet ndaj palëve të tjera pak më poshtë se kërkesat rregullatore, limite të cilat janë mbajtur vazhdimisht nga Banka.

Kreditë dhe paradhëniet për bankat janë dhënë pa kolateral. Tabela e mëposhtme paraqet llogaritë rrjedhëse të Bankës dhe depozitat me afat në bankat përkatëse sipas vlerësimeve të kredisë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2020
<i>Pa vonesë dhe pa rënie në vlerë</i>		
- nga vlerësimi AA+ në AA-	13,967	14,975
- nga vlerësimi A+ në A-	16,596	20,698
- nga vlerësimi BBB+ në B-	9,353	5,036
Gjithsej të arkëtueshmet nga bankat tjera	39,916	40,710

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kreditë dhë paradhëniet për klientë

në mijëra euro

	Kredi personale	Kredi biznesore	Gjithsej
31 dhjetor 2020			
<i>Faza 1</i>			
Shuma bruto e papaguar	62,778	433,038	495,816
Lejimi për humbje në kreditë e klientëve	(1,631)	(5,731)	(7,362)
Vlera neto e mbetur	61,147	427,307	488,454
<i>Faza 2</i>			
Shuma bruto e papaguar	820	20,103	20,923
Lejimi për humbje në kreditë e klientëve	(71)	(1,996)	(2,067)
Vlera neto e mbetur	750	18,106	18,856
<i>Faza 3</i>			
Shuma bruto e papaguar	1,773	15,531	17,304
Lejimi për humbje në kreditë e klientëve	(1,154)	(9,582)	(10,736)
Vlera neto e mbetur	619	5,949	6,568
<i>POCI</i>			
Shuma bruto e papaguar	55	979	1,034
Lejimi për humbje në kreditë e klientëve	(49)	(609)	(658)
Vlera neto e mbetur	6	370	376
Gjithsej shuma bruto e papaguar	65,426	469,651	535,077
Gjithsej lejimet për humbje në kreditë e klientëve	(2,905)	(17,918)	(20,823)
Gjithsej vlera neto e mbetur	62,521	451,733	514,254
në mijëra euro			
	Kredi personale	Kredi biznesore	Gjithsej
31 dhjetor 2019			
<i>Faza 1</i>			
Shuma bruto e papaguar	81,594	410,450	492,044
Lejimi për humbje në kreditë e klientëve	(1,203)	(4,206)	(5,409)
Vlera neto e mbetur	80,391	406,244	486,635
<i>Faza 2</i>			
Shuma bruto e papaguar	934	14,661	15,595
Lejimi për humbje në kreditë e klientëve	(68)	(976)	(1,044)
Vlera neto e mbetur	866	13,685	14,551
<i>Faza 3</i>			
Shuma bruto e papaguar	1,555	12,886	14,441
Lejimi për humbje në kreditë e klientëve	(1,191)	(9,529)	(10,720)
Vlera neto e mbetur	364	3,357	3,721
<i>POCI</i>			
Shuma bruto e papaguar	-	675	675
Lejimi për humbje në kreditë e klientëve	-	(322)	(322)
Vlera neto e mbetur	-	353	353
Gjithsej shuma bruto e papaguar	84,083	438,672	522,755
Gjithsej lejimet për humbje në kreditë e klientëve	(2,462)	(15,033)	(17,495)
Gjithsej vlera neto e mbetur	81,621	423,639	505,260

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet për klientë (vazhdim)

Rënia në vlerë dhe provizionimi

Lejimi për humbje

Banka përcakton lejimet për humbje në vlerë të barabartë me humbjet e pritura për të gjitha pasuritë financiare të njohura në kosto të amortizuar, për të gjithë instrumentet financiare të njohura në vlerën e drejtë me ndryshimet e raportuara në vlerë të drejtë në të hyra tjera gjithpërfshirëse (HTGJ), dhe për instrumente financiare jashtë-bilancore. Në përgjithësi, përdoret modeli me tre faza për të raportuar lejimet për humbje. Vlerësimet dhe supozimet janë në veçanti të nevojshme për të përcaktuar faktorët e ardhshëm makroekonomik që të përfshihen. Për më tepër, përcaktimi i probabiliteteve në peshimin e skenarëve kërkon vendime diskrecionale.

Banka largon lejimet për humbje për zërat bilancor “Balancat me Banka Qendore”, “Kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave”, “Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve”, “Investimet në letra me vlerë” dhe për pasuritë financiare nën “Pasuritë e tjera”. Në përgjithësi, këto njihen në vlerë neto brenda zërave korrespondues në bilancin e gjendjes, përveç “Investimet në letra me vlerë” që njihen në vlerë të drejtë. Lejimet për humbje në “Investimet në letra me vlerë” direkt në kapitalin aksionar nën “Rezervën e rivlerësimit”.

Banka përdor modelin për rënie në vlerë të humbjes së pritur që kërkon njohjen e humbjeve të pritshme të kredisë në kohën e duhur për të siguruar që shuma e humbjeve të pritshme të kredisë të njohura në çdo datë raportimi pasqyrojnë ndryshimet në riskun kreditor të instrumenteve financiare. Modeli bazohet në të ardhmen dhe zëvendëson modelin e humbjeve të ndodhura për njohjen e humbjeve kreditore, duke njohur humbjet e kreditit që jo domosdoshmërisht janë shkaktuar nga një ngjarje e mundshme humbjeje.

Në mënyrë të veçantë, modeli adreson kërkesat e SNRF 9 për matjen e humbjeve të pritura të kredisë bazuar në informacione të arsyeshme dhe të mbështetshme që janë në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme, duke përfshirë informacione historike, aktuale dhe të parashikuara.

Ky model përshkruan tri faza bazuar në ndryshimet në rrezikun e ekspozimit ndaj kredisë që nga data e njohjes fillestare.

- Faza I: Pasuritë financiare klasifikohen nën “Faza 1” kur njihen për here të parë. Banka përcakton lejimet për humbje në vlerë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore përgjatë një periudhe maksimale prej 12 muajsh prej datës së bilancit të gjendjes, meqë deri më tani nuk ka rritje të dukshme në rrezik kreditor që nga njohja fillestare
- Faza II: Nëse rreziku kreditor rritet dukshëm, pasuritë financiare klasifikohen nën “Faza 2” dhe lejimet për humbje përcaktohen në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore përgjatë tërë jetëgjatësisë së mbetur deri në maturitet.
- Faza III: Pasuritë financiare që kanë dështuar në pagesa klasifikohen nën “Faza 3” dhe lejimet për humbje përcaktohen në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore përgjatë tërë jetëgjatësisë së mbetur deri në maturitet. Për ekspozimet e mëdha, lejimi për humbje njihet në bazë të rrjedhave të rikuperueshme të parasë. Për ekspozimet që nuk janë të mëdha, lejimet për humbje njihen në bazë të parametrave të përcaktuar të portfolios. Të hyrat nga interesi njihen në vlera neto kontabël (minus lejimet për humbje). Faza 3 gjithashtu përfshin pasuritë financiare të cilat tashmë kanë rënie në vlerë në matjen fillestare në bilancin e gjendjes (POCI). Këto pasuri financiare njihen fillimisht në vlerën e drejtë, kështu që nuk njihen lejime për humbje. Pa marrë parasysh ndryshimet e ardhshme në rrezik kreditor, pasuritë POCI mbesin në Fazën 3 deri në momentin e shlyerjes nga bilanci. Që nga dhjetori i vitit 2020 u bënë rregullime në lidhje me numërimin e ditëve të kaluara si kriter për përcaktimin e mospërbushjes dhe treguesit të pamundësisë së shlyerjes së detyrimeve. Këto ndryshime u zbatuan si pjesë e prezantimit të përkufizimit të ndryshuar të mospagimit.

Për pozicionin “Pasuritë tjera”, lejimet për humbje përcaktohen duke përdorur metodën e thjeshtëzuar. Si rregull, lejimet për humbje njihen në momentin e njohjes dhe në çdo datë pasuese raportuese në një vlerë të barabartë me humbjet e pritura kreditore gjatë gjithësej periudhës së maturimit. Për këto pasuri që janë në përgjithësi afatshkurtëra, gjithësej periudha e maturitetit është përcaktuar të jetë 12 muaj.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Politika e shlyerjes

Banka shlyen një balancë të kredisë/letrave me vlerë (dhe ndonjë lejim të lidhur për humbjet nga rënia në vlerë) kur përcaktohet se kreditë/letrat me vlerë nuk janë të arkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pas marrjes në konsideratë të informatave të tilla si ndodhia e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit/emetuesit, në atë masë që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajë më detyrimin, ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të ripaguar tërë ekspozimin. Sa më e vogël të jetë shumata e papaguar, aq më i lartë është numri i ditëve në vonesë dhe sa më të mëdha të jenë pasiguritë rreth arkëtimit (siç është një mjedis i paparashikueshëm ligjor), aq më të vogla do të jenë shanset e arkëtimit nga Banka.

Arkëtimet e vlerave që janë shlyer më herët dhe shlyerjet direkte

Kur një kredi nuk është e arkëtueshme, shlyhet kundrejt lejimit për humbje që është vë mënjandë. Të tilla shlyerje ndodhin pasi që janë kompletuar të gjitha procedurat dhe është përcaktuar shumata e humbjes. Arkëtimet pasuese të vlerave të cilat janë shlyer, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes nën "Lejimet për humbje". Kreditë e pa arkëtueshme për të cilat nuk është ndarë lejimi për humbje në tërësi njihen në fitim ose humbje si shlyerje direkte.

Investimet në letrat me vlerë të matura nëpërmjet VDPHTGJ

Investimet në letrat me vlerë të borxhit janë me emetuesit shtetëror, bankat qendrore dhe huamarrësit tjerë ndërkombëtarë të vlerësuar me klasifikim kreditor AA ose më të lartë nga kompanitë Fitch, S&P ose Moody's. Ekspozimi ndaj letrave me vlerë të borxhit rregullohet nga Politika e Investimeve. Investimet lejohen vetëm në letrat me vlerë likuide që kanë vlerësime të larta të kreditit. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Tabela e mëposhtme paraqet tërë portfolion, i cili përfshin letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës të pa vlerësuar me klasifikim kreditor.

<i>31 dhjetor 2020</i>	Bonot e Qeverisë së Kosovës	Bonot e Qeverive OECD	Gjithsej
<i>Pa vonesë dhe pa rënie në vlerë:</i>			
- vlerësimi AAA	-	44,299	44,299
- vlerësimi AA+	-	-	-
- Të pavlerësuar (në nivel qeveritar ose shtetëror)	20,656	-	20,656
Gjithsej letrat me vlerë të borxhit të matura në VDPHTGJ	20,656	44,299	64,955
<hr/>			
<i>31 dhjetor 2019</i>	Bonot e Qeverisë së Kosovës	Bonot e Qeverive OECD	Gjithsej
<i>Pa vonesë dhe pa rënie në vlerë:</i>			
- vlerësimi AAA	-	50,566	50,566
- vlerësimi AA+	-	20,646	20,646
- Të pavlerësuar (në nivel qeveritar ose shtetëror)	15,787	-	15,787
Gjithsej letrat me vlerë të borxhit të matura në VDPHTGJ	15,787	71,212	86,999

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Zotimet e huadhënies dhe garancionet financiare

Ekspozimi maksimal nga garancionet financiare përfaqëson shumën maksimale që Banka do të paguajë nëse kërkohet garancioni, i cili mund të jetë dukshëm më i madh se shuma e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për zotimet e huadhënies është shuma e plotë e zotimit (shih Shënimin 26).

Politika e kontrollit të limitit dhe zvogëlimit të riskut

Banka menaxhon limitet dhe kontrollon përqendrimet e riskut të kredisë kudo që ato identifikohen në mënyrë të veçantë tek palët tjera dhe grupet individuale, si dhe tek bashkëpunëtorët.

Banka strukturon nivelet e riskut të kredisë që ajo ndërmer duke vendosur kufizime në sasinë e riskut të pranuar në lidhje me një huamarrës të vetëm ose grup huamarrësish si dhe në segmentet gjeografike dhe të industrisë. Këto risqe monitorohen në baza të rregullta dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme. Kufizimet në nivelin e riskut të kredisë sipas sektorit të produktit, rajonit dhe industrisë miratohen nga Bordi i Drejtorëve.

Ekspozimi ndaj riskut të kredisë udhëhiqet gjithashtu nëpërmjet analizës së rregullt të aftësisë së huamarrësve dhe huamarrësve potencial për të përmbushur detyrimet e ripagimit të interesit dhe të kapitalit si dhe duke ndryshuar kufizimet e huadhënies aty ku është e përshtatshme. Kontrollat e tjera dhe masat zbutëse janë të përshkruara më poshtë.

Kolaterali i mbajtur si dhe përmirësimet e tjera të kredisë, dhe efektet e tyre financiare

Banka përdor një sërë politikash dhe praktikash për të zbutur riskun kreditor, më e zakonshme nga të cilat është siguria për avanset e fondeve. Banka zbaton udhëzime për pranueshmërinë e klasave specifike të kolateralit ose zbutjen e riskut të kredisë. Llojet kryesore të kolateralit për huatë dhe paradhëniet janë:

- Hipotekat mbi pronat banesore;
- Ngarkesat mbi asetet e biznesit si ndërtesa, pajisje dhe inventar; dhe
- Ngarkesat mbi paranë e gatshme dhe ekuivalentët e saj (kolaterali i parasë së gatshme).

Në përgjithësi, kreditë ndaj subjekteve të korporatave dhe individëve sigurohen; mbitërheqjet individuale dhe kartat e kreditit të lëshuara për individët sigurohen nga kolaterali i parasë ose lloje të tjera kolaterali të përcaktuara me vendim të komisioneve të kredive.

Përveç kësaj, me qëllim që të minimizohet humbja e kredisë, Banka do të kërkojë kolateral shtesë nga pala tjetër sapo treguesit e zhvlerësimit të shënohen për huatë dhe paradhëniet përkatëse individuale.

Efekti financiar i kolateralit paraqitet duke shpalosur vlerat kolaterale veçmas për:

- Ato pasuri ku kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë janë të barabarta ose tajakalojnë vlerën kontabël të pasurisë (“pasuri të mbingarkuara”); dhe
- Ato pasuri ku kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë janë më të vogla se vlera kontabël e pasurisë (“pasuri nën kolateral”).

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2020	Mbi-kolateralizuara		Nën-kolateralizuara	
	Vlera kontabël e pasurisë	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera kontabël e pasurisë	Vlera e drejtë e kolateralit
Biznese	259,938	688,916	166,049	127,641
Privat	29,116	95,976	59,151	14,816
	289,054	784,892	225,200	142,458

Më 31 dhjetor 2019	Mbi-kolateralizuara		Nën-kolateralizuara	
	Vlera kontabël e pasurisë	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera kontabël e pasurisë	Vlera e drejtë e kolateralit
Biznese	269,346	707,959	138,033	102,489
Privat	30,616	97,902	67,265	14,710
	299,962	805,861	205,298	117,199

Vlera e drejtë e kolateralit vlerësohet nga Banka në baza individuale. Vlerat e vlerësuara përgjithësisht përcaktohen duke i'u referuar tregut. Të ardhurat e pritshme nga likuidimi i kolateralit gjithashtu merren parasysh në llogaritjen e provizioneve individuale të zhvlerësimit.

Përqëndrimi i riskut kreditor

Përqëndrimet lindin kur një numër i palëve janë të angazhuar në aktivitete të ngjashme të biznesit ose aktivitete në të njëjtin rajon gjeografik, apo kanë karakteristika të ngjashme ekonomike të cilat do të shkaktonin që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohej në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushtet ekonomike, politike ose të tjera. Përqëndrimet tregojnë ndjeshmërinë relative të performancës së Bankës ndaj zhvillimeve që ndikojnë në një industri të caktuar ose vendndodhje gjeografike.

Sektorët gjeografik

Tabela në vijim shpalos ekspozimin kryesor kreditor të Bankës në shumën e tyre bruto, sipas kategorive të rajonit gjeografik më 31 dhjetor 2020 dhe 2019. Banka ka ndarë ekspozimet ndaj rajoneve bazuar në vendin e banimit të palëve të saj.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(iii) Përqëndrimi i riskut kreditor (vazhdim)

	2020			2019		
	Shtetet OECD	Kosova	Gjithsej	Shtetet OECD	Kosova	Gjithsej
Pasuritë						
Balancat me Bankat Qendrore	149,075	63,271	212,346	59,022	55,922	114,944
Kreditë dhe paradhëniet për banka	39,916	-	39,916	40,710	-	40,710
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	-	514,254	514,254	-	505,260	505,260
Investimet në letrat me vlerë të matura në VDPHTGJ	44,299	20,656	64,955	71,212	15,787	86,999
Pasuritë tjera financiare	-	1,851	1,851	-	2,319	2,319
Gjithsej pasuritë	233,290	600,032	833,322	170,944	579,288	750,232
Detyrimet						
Detyrimet ndaj bankave tjera	41	567	608	70	645	715
Detyrimet ndaj klientëve	65,895	683,903	749,798	55,085	618,028	673,113
Huamarrjet	24,981	-	24,981	19,906	-	19,906
Borxhi i varur	7,537	-	7,537	7,538	-	7,538
Detyrimet tjera financiare	-	1,249	1,249	-	1,436	1,436
Gjithsej detyrimet	98,454	685,719	784,173	82,599	620,109	702,708

Industria

	2020			2019		
	Privat	Biznese	Gjithsej	Privat	Biznese	Gjithsej
Pasuritë						
Balancat me Bankat Qendrore	-	212,346	212,346	-	114,944	114,944
Kreditë dhe paradhëniet për banka	-	39,916	39,916	-	40,710	40,710
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	62,522	451,732	514,254	99,324	405,936	505,260
Investimet në letrat me vlerë të matura në VDPHTGJ	-	64,955	64,955	-	86,999	86,999
Pasuritë tjera financiare	-	1,851	1,851	-	2,319	2,319
Gjithsej pasuritë	62,522	770,800	833,322	99,324	650,908	750,232
Liabilities						
Detyrimet ndaj bankave tjera	-	608	608	-	715	715
Detyrimet ndaj klientëve	456,055	293,743	749,798	485,925	187,188	673,113
Huamarrjet	-	24,981	24,981	-	19,906	19,906
Borxhi i varur	-	7,537	7,537	-	7,538	7,538
Detyrimet tjera financiare	-	1,249	1,249	-	1,436	1,436
Gjithsej detyrimet	456,055	328,118	784,173	485,925	216,783	702,708

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Banka nuk do të jetë më në gjendje të përmbushë detyrimet e saj të tanishme dhe të ardhshme të pagesave në mënyrë të plotë, ose në kohën e duhur. Prandaj, Banka duhet të mbajë në çdo kohë fonde të mjaftueshme likuide në dispozicion për të përmbushur detyrimet e saj, edhe në rast të rrethanave të mundshme të jashtëzakonshme. Risku i likuiditetit është gjithashtu risku që nuk mund të merret financim shtesë, ose mund të merret vetëm me rritjen e normave të interesit të tregut. Kjo mund të shkaktohet nga ndërprerjet e tregut ose uljet e kreditit të cilat mund të shkaktojnë që burimet e caktuara të financimit të mos bëhen të disponueshme. Për të zvogëluar riskun e likuiditetit, Banka diversifikon burimet e financimit dhe menaxhon pasuritë duke marrë masa të likuiditetit, duke ruajtur një gjendje të parasë së gatshme dhe të ekuivalentëve të parasë, mjaftueshëm për të përmbushur obligimet mbi detyrimet e menjëhershme.

Tabela më poshtë paraqet analizën e likuiditetit të maturimeve kontraktuale të mbetura, të paskontuara në datën e raportimit dhe të grupuara sipas maturimeve të pritshme të pasurive dhe detyrimeve financiare. Shumat e shpalosura në pjesën e parë të tabelës janë flukse monetare kontraktuale të skontuara, ndërsa Banka menaxhon riskun e përhershëm të likuiditetit në një bazë të pritshme, bazuar në hyrjet e pritshme të skontuara të parasë së gatshme dhe daljet e raportuara në pjesën e dytë. Në transformimin e detyrimeve nga kontraktuale në të pritshme, Banka konsideron dy grupe të supozimeve: supozimet e para të cilat rekomandohen nga ProCredit Holding dhe të cilat janë të bazuara në Rregulloren Gjermane të Likuiditetit; dhe supozimet e dyta rrjedhin nga analiza historike e depozitave të klientëve dhe modeli i tyre i tërheqjes.

Banka synon të ruajë hendekun kumulativ të maturimit pozitiv gjatë gjithë kohës. Nëse hendeku kumulativ i maturitetit pritet të jetë negativ, jo pozitiv, Banka e konsideron likuiditetin si një "pozicion të likuiditetit në vëzhgim".

Shifrat e raportuara në mjetin raportues më poshtë nuk përputhen me pasqyrën e pozicionit financiar, për shkak të faktit se përveç pozicioneve bilancore, Banka ka marrë në konsideratë edhe pozicionet jashtë-bilancore. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet financiare raportohen në bazë të kohës kur detyrimet (duke përfshirë detyrimet kontigjente nga garancionet e Bankës, letrat e kreditit dhe zotimet e tjera të lidhura me kredinë) bëhen të detyrueshme dhe pasuritë mund të përdoren si burim shlyerjeje (duke përfshirë zërat jashtë-bilancor siç janë zotimet e pashfrytëzuara, parevokueshme dhe të pakuzhtëzuara të kredisë të cilat Banka mund t'i përdorë si burim likuiditeti në çdo kohë pa miratim paraprak).

Në tabelën e hendekut të likuiditetit të paraqitur më poshtë, përkufizimet e mëposhtme konsiderohen relevante:

- Pasuritë 1 - janë pasuri të cilat nuk kanë një maturim kontraktual dhe/ose mund të konvertohen në para të gatshme shumë shpejt;
- Pasuritë 1-S – janë pasuri që kanë një maturim kontraktual dhe shpërndarja në suaza kohore bazohet në maturitetet e mbetura;
- Detyrimet 1 – janë detyrime të cilat janë të pagueshme sipas kërkesës kontraktuale; dhe
- Detyrimet 1-S – janë detyrime që kanë një maturim kontraktual dhe shpërndarja në suaza kohore bazohet në maturitetet e mbetura.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i likuiditetit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2020	Deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	> 1 vit	Gjithsej
Pasuritë 1						
Paraja e gatshme	50,731	-	-	-	-	50,731
Rezervat me Bankën Qendrore	43,100	-	-	-	-	43,100
Llogaritë rrjedhëse me Bankat Qendrore	169,278	-	-	-	-	169,278
Llogaritë rrjedhëse me bankat	18,904	447	1,450	1,265	1,751	23,817
Zotimet kreditore të papërdorura	-	-	-	-	-	-
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme	2,018	6,650	825	30,575	24,887	64,955
Pasuritë 1-S						
Depozitat me afat në banka	4,073	8,479	4,075	-	-	16,627
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	26,625	44,149	53,989	127,930	327,655	580,348
Gjithsej Pasuritë	316,729	59,725	60,339	159,770	354,294	950,856
Detyrimet kontraktuale						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (në baza ditore)	367	-	-	-	-	367
Detyrimet ndaj klientëve (në baza ditore)	623,588	-	-	-	-	623,588
Detyrimet kontingjente nga garancionet	34,114	-	-	-	-	34,114
Zotimet kreditore të papërdorura	69,168	-	-	-	-	69,168
Detyrimet 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	3,896	5,250	5,549	24,294	42,141	81,129
Huamarrjet dhe borxhi i varur	2,143	345	488	4,949	30,976	38,901
Gjithsej Detyrimet kontraktuale	733,275	5,595	6,037	29,243	73,117	847,267
Hendeku Periodik Kontraktual i Likuiditetit	(416,547)	54,130	54,302	130,527	281,176	103,589
Hendeku Kumulativ Kontraktual i Likuiditetit	(416,547)	(362,417)	(308,115)	(177,587)	103,589	-
Detyrimet e Pritura						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (në baza ditore)	292	-	-	-	-	292
Detyrimet ndaj klientëve (në baza ditore)	38,826	15,867	32,258	29,812	519,524	636,287
Detyrimet kontingjente nga garancionet	1,706	-	-	-	-	1,706
Zotimet kreditore të papërdorura	6,917	-	-	-	-	6,917
Detyrimet 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	3,896	5,250	5,549	24,294	42,141	81,129
Huamarrjet dhe borxhi i varur	2,143	345	488	4,949	30,976	38,901
Gjithsej Detyrimet e Pritura	53,779	21,462	38,295	59,055	592,641	765,231
Hendeku Periodik i Pritshëm i Likuiditetit	262,950	38,263	22,044	100,715	(238,347)	185,624
Hendeku Kumulativ i Pritshëm i Likuiditetit	262,950	301,213	323,257	423,972	185,624	-

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i likuiditetit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2019	Deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	> 1 vit	Gjithsej
Pasuritë 1						
Paraja e gatshme	43,001	-	-	-	-	43,001
Rezervat me Bankën Qendrore	37,760	-	-	-	-	37,760
Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore	77,214	-	-	-	-	77,214
Llogaritë rrjedhëse me bankat	7,782	533	1,470	2,561	1,369	13,714
Zotimet kreditore të papërdorura	-	-	-	-	-	-
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme	19,760	12,394	7,481	36,729	10,635	86,999
Pasuritë 1-S						
Depozitat me afat në banka	1,788	13,292	12,501	-	-	27,581
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	23,873	46,903	66,242	134,378	299,503	570,899
Gjithsej Pasuritë	211,177	73,122	87,694	173,668	311,507	857,168
Detyrimet kontraktuale						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (në baza ditore)	539	-	-	-	-	539
Detyrimet ndaj klientëve (në baza ditore)	558,809	-	-	-	-	558,809
Detyrimet kontingjente nga garancionet	36,500	-	-	-	-	36,500
Zotimet kreditore të papërdorura	58,261	-	-	-	-	58,261
Detyrimet 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	3,141	4,135	7,980	28,261	42,444	85,960
Huamarrjet dhe borxhi i varur	-	-	488	1,568	28,881	30,937
Gjithsej Detyrimet kontraktuale	657,250	4,135	8,468	29,829	71,325	771,007
Hendeku Periodik Kontraktual i Likuiditetit	(446,073)	68,987	79,226	143,839	240,182	86,161
Hendeku Kumulativ Kontraktual i Likuiditetit	(446,073)	(377,086)	(297,860)	(154,021)	86,161	-
Detyrimet e Pritura						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (në baza ditore)	329	-	-	-	-	329
Detyrimet ndaj klientëve (në baza ditore)	42,807	22,492	31,374	59,179	413,340	569,193
Detyrimet kontingjente nga garancionet	1,825	-	-	-	-	1,825
Zotimet kreditore të papërdorura	5,826	-	-	-	-	5,826
Detyrimet 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	3,141	4,134	7,980	28,261	42,444	85,960
Huamarrjet dhe borxhi i varur	-	-	488	1,568	28,881	30,937
Gjithsej Detyrimet e Pritura	53,929	26,626	39,842	89,008	484,665	694,070
Hendeku Periodik i Pritshëm i Likuiditetit	157,248	46,496	47,852	84,660	(173,158)	163,098
Hendeku Kumulativ i Pritshëm i Likuiditetit	157,248	203,744	251,596	336,256	163,098	-

Për qëllime likuiditeti, Banka klasifikon depozitat e afatizuara dhe të kursimit sipas afatit dhe maturimit brenda një muaji. Si rezultat, hendeku kontraktual i likuiditetit deri në dymbëdhjetë muaj është rritur. Megjithatë, mundësia që sasi të mëdha të depozitave të klientëve të tërhiqen nga Banka është shumë e vogël. Prandaj, Banka nuk e konsideron hendekun e likuiditetit në afat të shkurtër. Ajo përqendrohet më shumë në hendekun e pritshëm të likuiditetit i cili paraqet një skenar më të mundshëm. Banka mban një portfolio të pasurive financiare shumë të tregtueshme (investime me vlerë të matura në VDPHTGJ) që lehtë mund të likuidohen si mbrojtje nga çdo ndërprerje e paparashikuar në rrjedhës e parasë. Menaxhmenti i Bankës është duke monitoruar raportet e likuiditetit ndaj kërkesave të brendshme dhe rregullative në baza ditore, javore dhe mujore. Si rezultat, Menaxhmenti beson se Banka nuk ka hendek afatshkurtër të likuiditetit. Gjatë vitit 2020, Banka aplikoi testimin e stresit të likuiditetit në baza mujore për të gjitha monedhat operative dhe e diskutoi atë rregullisht në Komitetin e Menaxhimit të Financave dhe Riskut të Tregut të Bankës dhe Komitetin e Menaxhimit të Pasurive dhe Detyrimeve (ALCO). Testi i stresit kryhet duke aplikuar katër skenarë të ndryshëm sipas politikës së administrimit të rrezikut të likuiditetit, duke filluar nga skenarët më pak deri në më shumë konservatorë.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumtat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i likuiditetit (vazhdim)

Në rast se Bordi Menaxhues dhe Funkzioni i Monitorimit të Riskut shohin ndonjë gjë që kërkon vëmendje në këto skenarë, Banka merr masat e nevojshme për të minimizuar çdo rrezik.

(d) Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Bankës gjatë menaxhimit të kapitalit janë: (i) të jetë në përputhje me kërkesat e kapitalit të përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK); (ii) për të ruajtur aftësinë e Bankës për të vazhduar sipas parimit të vijmësisë së biznesit në mënyrë që të vazhdojë të ofrojë kthime për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera të interesuara dhe (iii) të mbajë një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e biznesit të saj.

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator monitorohen çdo muaj nga menaxhmenti i Bankës, duke përdorur teknika të bazuara në udhëzimet e BQK-së. Informacioni i kërkuar i ofrohet BQK-së në baza mujore.

Pasuritë me risk të ponderuar maten me anë të një hierarkie prej pesë ponderimeve të riskut të klasifikuara sipas natyrës dhe pasqyrojnë një vlerësim riskut të kredisë, tregut dhe risqeve të tjera që lidhen me secilën pasuri dhe ekspozim jashtë bilancit, me disa përshtatje që pasqyrojnë natyrën e kushtëzuar të disa humbjeve të mundshme.

BQK-ja kërkon që Banka të mbajë nivelin minimal të kapitalit rregullator prej 7,000 mijë euro, për të ruajtur një raport të kapitalit të klasës I ndaj pasurisë me risk të ponderuar ("Raporti i Baselit") në ose mbi minimumin prej 9% (Aktualisht, 17.55% ndërsa në 2019: 15.13%), dhe për të ruajtur një kapital rregullator të përgjithshëm të klasës II, ndaj pasurive me risk të ponderuar nën ose mbi minimumin prej 12% (Aktuale 20.02% ndërsa në 2019: 17.57%). Prandaj, bazuar në raportet përkatëse, Banka ishte në përputhje me kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit në datat e raportimit, më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës të matura në përputhje me rregullat e BQK-së janë si më poshtë:

	2020	2019
Kapitali i Klasës 1		
Kapitali aksionar dhe primi i aksioneve	65,550	65,550
Rezervat	6,956	511
Fitimi i mbajtur	32,328	26,367
Minus: Pasuritë e paprekshme	(51)	(20)
Minus: Kreditë për personat e lidhur me bankën	(4,110)	(4,519)
Minus: Pasuritë tatimore të shtyera	(183)	(229)
Gjithsej kapitali i kualifikueshëm në klasën 1	100,490	87,660
Kapitali i Klasës 2		
Detyrimi i varur	7,500	7,500
Provizionet për humbje të kredive (kufizuar Në 1.25% të RWA)	6,619	6,672
Gjithsej kapitali i kualifikueshëm në klasën 2	14,119	14,172
Gjithsej kapitali rregullator	114,609	101,832
Pasuritë me risk të ponderuar		
Zërat bilancor	501,778	508,607
Zërat jashtë bilancor	27,717	25,181
Pasuritë me risk për riskun operacional	43,032	45,743
Gjithsej pasuritë me risk të ponderuar	572,528	579,531
Raporti i mjaftueshmërisë së Kapitali të Klasës I	17.55%	15.13%
Raporti i mjaftueshmërisë së Kapitali të Klasës II	20.02%	17.57%

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)
(e) Kapitali ekonomik

Përveç raporteve të kapitalit rregullator, Banka vlerëson mjaftueshmërinë e saj të kapitalit duke përdorur konceptin e kapitalit ekonomik, për të pasqyruar profilin specifik të riskut të Bankës, përkatësisht duke krahasuar humbjet e mundshme që rrjedhin nga operimi i saj me kapacitetin e Bankës për të përballuar humbje të tilla. Konceptet e mëposhtme janë përdorur për të llogaritur humbjet e mundshme në kategoritë e ndryshme të riskut:

- Risku i kredisë (klientët): Bazuar në një analizë migrimi të përditësuar rregullisht në portfolion e kredisë, llogaritet shkalla historike e humbjeve dhe shpërndarja e tyre statistikore. Normat historike të humbjeve në kategori të ndryshme të ditëvonesave (me një nivel besueshmërie prej 99%) aplikohen në portfolion e kredisë për të llogaritur humbjet e mundshme të kredisë.
- Risku i palës tjetër: Llogaritja e humbjeve të mundshme për shkak të riskut të palës tjetër bazohet në probabilitetin e dështimit që rrjedhë nga vlerësimi përkatës ndërkombëtar i palës ose vendit përkatës të veprimtarisë (pas rregullimit).
- Risku i tregut: Ndërsa luhatjet historike të valutës analizohen statistikiisht dhe variacioni më i lartë (niveli i besueshmërisë 99%) zbatohet për pozicionet aktuale të valutës, risku i normës së interesit llogaritet duke përcaktuar ndikimin e vlerës ekonomike të një goditje standarde të normës së interesit për EUR/USD (2 pikë përqindjeje, goditja e normës së interesit Basel) dhe nivelet më të larta (historike) të goditjes për valutat e tjera.
- Risku operacional: Për të llogaritur vlerën përkatëse përdoret çasja standarde e Basel II.

Banka tregoi një nivel modest të shfrytëzimit të RAAtCR më 31 dhjetor 2020. Përdorimi i limitit të riskut të palëve tjera dhe të tregut është përsëri i ulët, duke reflektuar çasjen e menaxhimit të rrezikshëm që udhëzon operacionet e thesarit të Bankës. Kapitali ekonomik i kërkuar për të mbuluar riskun operacional llogaritet sipas çasjes standarde të Basel II. Të dhënat e grumbulluara gjatë vitit 2020 në Databazën e Ngjarjeve së Riskut (RED), që kap të dhënat e ngjarjeve të riskut në një shkallë bankare të gjerë në grup, tregojnë një nivel të ulët të riskut operacional. Të gjitha risqet e kombinuara, të kuantifikuara sipas metodave të përcaktuara nga politikat e Bankës, janë nën kufirin prej 60% të totalit të kapacitetit mbajtës të riskut të Bankës.

6. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera e drejtë e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregjet aktive bazohen në çmimet e kuotuarat të tregut ose në kuotat e çmimeve të tregtarëve. Për të gjitha instrumentet e tjera financiare, Banka përcakton vlerat e drejta duke përdorur teknika të tjera të vlerësimit. Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë pak transparencë të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon shkallë të ndryshme të gjykimit në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve të çmimeve dhe risqeve të tjera që ndikojnë në instrumentin specifik.

a. Modelet e vlerësimit

Banka matë vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë, e cila reflekton rëndësinë e inputeve të përdorura në kryerjen e matjeve.

Niveli 1: inputet që janë çmime të tregut të kuotuarat (të pa rregulluara) në tregjet aktive për pasuritë ose detyrimet identike të cilave njësisia ekonomike mund t'u qaset në datën e matjes.

Niveli 2: Inpute të ndryshme nga çmimet e kuotuarat të përfshira në Nivelin 1 që janë të vëzhgueshme për pasurinë ose detyrimin qoftë në mënyrë direkte (si çmime) ose indirekte (të përfituara nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuarat duke përdorur: çmimet e tregut të kuotuarat në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuarat për instrumente identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak se aktive; ose teknika të tjera të vlerësimit në të cilat të gjitha inputet e rëndësishme janë direkt ose indirekt të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

Niveli 3: inputet që nuk janë të vëzhgueshme për pasurinë ose detyrimin. Kjo kategori përfshin të gjitha instrumentet për të cilat teknikat e vlerësimit përfshijnë inpute që nuk janë të bazuara në të dhënat e vëzhgueshme dhe inputet që nuk janë të vëzhgueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare (vazhdim)

a. Modelet e vlerësimit (vazhdim)

Kjo kategori përfshin instrumente që vlerësohen në bazë të çmimeve të kuotuarra për instrumente të ngjashme për të cilat kërkohen rregullime ose supozime të konsiderueshme të pavëzhgueshme për të pasqyruar ndryshimet midis instrumenteve.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e flukseve të mjeteve monetare të skontuara, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmimet e vëzhgueshme të tregut dhe modelet e tjera të vlerësimit.

Supozimet dhe inputet e përdorura në teknikat e vlerësimit përfshijnë normat e interesit pa risk dhe normat bazë, përhapjet e kredisë dhe primet e tjera të përdorura në vlerësimin e normave të skontimit, çmimet e bonove dhe të kapitalit, kurset e këmbimit valutor, çmimet e kapitalit dhe çmimet e indeksit të kapitalit si dhe volatilitetet e pritshme të çmimeve dhe korrelacionet. Qëllimi i teknikave të vlerësimit është të arrijë një matje të vlerës së drejtë që pasqyron çmimin që do të merret për të shitur pasurinë ose që do të paguhet për të transferuar detyrimin në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare të zakonshme dhe më të thjeshta, siç janë këmbimet e normave të interesit dhe të valutës, të cilat përdorin vetëm të dhënat e tregut të vëzhgueshme dhe kërkojnë vlerësim dhe gjykim të pakët të menaxhmentit. Çmimet e vëzhgueshme ose inputet e modelit zakonisht janë të disponueshme në treg për letrat me vlerë të listuara të borxhit dhe kapitalit. Disponueshmëria e çmimeve të tregut të vëzhgueshme dhe inputeve të modeleve zvogëlon nevojën për gjykimin dhe vlerësimin e menaxhmentit dhe gjithashtu zvogëlon pasigurinë e lidhur me përcaktimin e vlerave të drejta. Disponueshmëria e çmimeve dhe inputeve të tregut të vëzhgueshme ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur për ndryshime në bazë të ngjarjeve specifike dhe kushteve të përgjithshme në tregjet financiare.

Vlerësimet e vlerës së drejtë të marra nga modelet janë përshtatur për çdo faktor tjetër, të tillë si risku i likuiditetit ose pasiguritë e modelit, deri në masën që Banka beson se një palë e tretë pjesëmarrëse në treg do t'i merrte parasysh në çmimin e një transaksioni. Vlera e drejtë reflekton riskun e kredisë të instrumentit dhe përfshin rregullime për të marrë parasysh riskun e kredisë të njësisë ekonomike të Bankës dhe të palës tjetër aty ku është e përshtatshme.

Inputet dhe vlerat e modeleve kalibrohen kundrejt të dhënave historike dhe parashikimeve të publikuara si dhe, aty ku është e mundur, kundër transaksioneve të vëzhgueshme aktuale ose të fundit në instrumente të ndryshme dhe kundër kuotave të ndërmjetësit. Ky proces i kalibrimit është në thelb subjektiv dhe jep rangimet e inputeve të mundshme dhe vlerësimeve të vlerës së drejtë, si dhe gjykimi i menaxhmentit është i nevojshëm për të zgjedhur pikën më të përshtatshme në rang.

b. Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë

Tabela në vijim analizon instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë në datën e raportimit, sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën kategorizohet matja e vlerës së drejtë. Këto vlera njihen në pasqyrën e pozicionit financiar.

	Gjithsej vlera e drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
31 dhjetor 2020	64,955	44,299	20,656	-
Obligacionet	64,955	44,299	20,656	-
Bonot e Thesarit	-	-	-	-
31 dhjetor 2019	86,999	71,211	15,788	-
Obligacionet	86,270	71,211	15,059	-
Bonot e Thesarit	729	-	729	-

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare (vazhdim)

c. Instrumentet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë për të cilat është shpалosur vlera e drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerat e drejta të instrumenteve financiare që nuk maten me vlerën e drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën kategorizohet çdo matje e vlerës së drejtë.

	31 dhjetor 2020			31 dhjetor 2019		
	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3
<i>Pasuritë financiare</i>						
<i>Kreditë dhe të arkëtueshmet</i>						
Paraja e gatshme dhe balancat me Bankën Qendrore	263,109	263,109	-	157,975	157,975	-
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	39,916	39,916	-	40,710	40,710	-
Llogaritë rrjedhëse	23,286	23,286	-	13,136	13,136	-
Depozitat me afat me bankat	16,630	16,630	-	27,575	27,575	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	514,254	-	503,075	505,260	-	494,276
Kreditë fikse	512,878	-	501,729	504,400	-	493,435
Kredi bujqësore	2,700	-	2,641	4,768	-	4,664
Kredi biznesi	406,069	-	397,242	392,441	-	383,910
Kredi private	1,696	-	1,659	3,098	-	3,031
Kredi për shtëpi	102,412	-	100,186	104,056	-	101,794
Kredi të tjera	1,377	-	1,347	897	-	878
Pasuritë tjera financiare	1,851	1,851	-	2,319	2,319	-
<i>Detyrimet financiare</i>						
Detyrimet ndaj bankave	608	608	-	715	715	-
Depozitat e klientëve	749,798	653,578	96,186	673,113	569,276	103,951
Llogaritë rrjedhëse	484,388	484,388	-	421,451	421,451	-
Llogaritë e kursimit	164,948	164,948	-	143,927	143,927	-
Depozitat me afat	96,220	-	96,186	103,837	-	103,951
Llogaritë tjera të klientëve	4,242	4,242	-	3,898	3,898	-
Huamarrjet dhe borxhi i varur	32,518	-	32,518	27,444	-	27,444
Huamarrjet	24,981	-	24,981	19,906	-	19,906
Borxhet e varura	7,537	-	7,537	7,538	-	7,538
Detyrime tjera financiare	1,249	1,249	-	1,436	1,436	-

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe paradhënieve bazohet në transaksione të vëzhgueshme të tregut. Aty ku transaksionet e vëzhgueshme të tregut nuk janë në dispozicion atëherë, vlera e drejtë vlerësohet duke përdorur modelin e vlerës së drejtë, siç është teknika e skontimit të flukseve monetare. Inputi në teknikën e vlerësimit përfshin humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetëgjatësisë, normat e interesit dhe normat e parapagimit. Për kreditë e provizionuara të mbështetura me kolateral, vlera e drejtë matet në bazë të vlerës së kolateralit bazë. Për kreditë private dhe kreditë komerciale më të vogla, kreditë homogjene janë grupuar në portfolio me karakteristika të ngjashme.

Vlera e drejtë e depozitave nga bankat dhe klientët vlerësohet duke përdorur teknika të fluksit të mjeteve monetare të skontuar, duke aplikuar normat që ofrohen për depozitat me maturim dhe afate të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme me afat është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

Vlera e drejtë e huave dhe e borxhit të varur bazohet në flukset monetare kontraktuale të skontuara, duke marrë parasysh normat e interesit të tregut, të cilat do të ishin të pagueshme nga Banka kur ka nevojë për zëvendësimin e burimeve të vjetra me ato të reja me maturim të barabartë të mbetur.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

7. Të hyrat neto nga interesi

	2020	2019
Të hyrat nga interesi		
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	27,866	29,512
Kreditë dhe paradhëniet për banka	(88)	98
Letrat me vlerë të investimit të matura në VDPHTGJ	214	315
Të tjera	19	25
Gjithsej të hyrat nga interesi	28,011	29,950
Shpenzimet e interesit		
Detyrimet ndaj klientëve	1,575	1,110
Fondet e huazuara	660	730
Të tjera	114	117
Gjithsej shpenzimet e interesit	2,349	1,957
Të hyrat neto nga interesi	25,662	27,993

Të ardhurat nga interesi i kredive dhe paradhënieve të klientëve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, përfshijnë 751 mijë euro (2019: 1,048 mijë euro) dhe 130 mijë euro (2019: 167 mijë euro) që lidhen me interesin aktual dhe lëshimin e normës së skontimit të kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve me rënie në vlerë.

8. Të hyrat neto nga tarifat dhe komisionet

	2020	2019
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet		
Transferet e pagesave dhe transaksionet	3,699	3,834
Kartelat e debitit dhe kreditit	2,008	2,842
Tarifat e mirëmbajtjes së llogarisë	5,316	6,238
Letrat e kreditit dhe garancionet	730	739
Tarifa dhe komisione të tjera	482	347
Gjithsej të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	12,235	14,000
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve		
Ofruesi i IT-së dhe shërbimet e lidhura	673	856
Tarifat dhe komisionet për llogaritë bankare	981	690
Tarifa të tjera për bankat	657	705
Tarifat dhe shpenzimet që lidhen me kartelat	283	295
Tarifat e transaksionit të palëve të treta	2,282	2,293
Tarifa të tjera	202	201
Gjithsej shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	5,078	5,040
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	7,157	8,960

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

9. Shpenzimet administrative dhe shpenzimet tjera operative

	2020	2019
Shpenzimet e personelit (shiko më poshtë)	4,890	5,038
Mirëmbajtja dhe riparimet	3,448	2,402
Shpenzime të tjera	1,863	4,901
Zhvlerësimi dhe amortizimi (shih shënimet 15 dhe 16)	1,413	2,085
Tarifat e konsulencës, ligjore dhe tarifa tjera	1,261	1,035
Shpenzimet për ProCredit Holding	915	699
Fondi i sigurimit të depozitave	765	873
Shërbimet e sigurimit	665	619
Shpenzimet e reklamës dhe promovimit	473	695
Rojalitetet në softuer	457	600
Komunikimi (telefon, lidhje online)	365	367
Komunalitë	263	241
Shpenzimet e trajnimit	261	586
Rënia në vlerë e pasurisë fikse	176	1,062
Furnizimet me material për zyre	153	158
Transporti (karburant, mirëmbajtje)	102	164
Heqja nga përdorimi i pronës dhe pajisjeve	42	2,095
Shpenzimet e qirasë	30	63
Provizionet për garancionet e dhëna	-	498
	17,542	24,181

Shpenzimet për provizione për garancitë e dhëna, në pasqyrën e fitimit ose humbjes paraqiten brenda lejimit për humbje nga rënia në vlerë e huave dhe paradhënieve për klientët.

Më 31 dhjetor 2020 Banka kishte 278 punonjës (2019: 256 punonjës).

	2020	2019
Pagat dhe mëditjet	4,494	4,457
Kontributi pensional	222	223
Përfitimet dytësore	107	101
Kompensimet tjera	67	257
	4,890	5,038

10. Tatimi në fitim

Shumat e njohura në fitim ose humbje

	2020	2019
Shpenzimet aktuale të tatimit	1,505	2,245
Tatimi i shtyrë (të ardhurat)/shpenzimet	(622)	483
Shpenzimet e tatimit në të ardhura	883	2,728

Tatimi mbi fitimin aktual llogaritet në bazë të rregullave të tatimit në fitim të aplikueshme në Kosovë, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit. Norma e tatimit në fitimin e korporatave është 10% (2019: 10%).

Shumat e njohura në të Hyrat e Tjera Gjithëpërfshirëse (HTGJ)

	2020			2019		
	Para tatimit	Ngarkesa tatimore	Neto nga tatimi	Para tatimit	Ngarkesa tatimore	Neto nga tatimi
Investimi në letra me vlerë të matura në VDPHTGJ	75	(8)	67	102	(10)	92
Gjithsej	75	(8)	67	102	(10)	92

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

10. Tatimi në fitim (vazhdim)

Barazimi i normës efektive të tatimit

Më poshtë është një barazim i tatimit në fitim i llogaritur me normën e aplikueshme tatimore prej 10% (2019: 10%) ndaj shpenzimeve aktuale të tatimit në fitim:

	2020	2019
Fitimi para tatimit	14,133	24,180
Tatimi duke përdorur normën e tatimit të korporatave	1,413	2,418
Të ardhurat e përjashtuara	(38)	(173)
Shpenzimet jo të zbritshme	131	-
Tatimi i shtyrë (të ardhurat)/shpenzimet	(622)	483
	883	2,728

Tatimi në fitim i parapaguar i pagueshëm më 31 dhjetor 2020 është 1,527 mijë euro (31 dhjetor 2019: tatimi në fitim i parapaguar i pagueshëm prej 1,061 mijë euro).

Lëvizja në balancat tatimore të shtyra

Tatimi i shtyrë llogaritet në bazë të normës së tatimit të miratuar prej 10% (2019: 10%).

	31 dhjetor 2019	Fitimi ose humbja	HTGJ	31 dhjetor 2020
Pasuritë tatimore të shtyra				
Interesi i përlogaritur nga kreditë	50	25	-	75
Zhvlerësimi i pronës dhe pajisjeve	119	(5)	-	114
Pasuritë e tjera financiare	8	(8)	-	-
	177	12	-	189
Detyrimet e shtyra tatimore				
Interesi përlogaritur nga kreditë	(102)	102	-	-
Investimi në letra me vlerë të matura në VDPHTGJ	(14)	-	8	(6)
Provizionet për rëniet në vlerë të kredive	(509)	509	-	-
	(625)	611	8	(6)
Pasuritë/(detyrimet) neto tatimore të shtyra	(448)	623	8	183

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

11. Paraja e gatshme dhe balancat me Bankat Qendrore

	2020	2019
Paraja e gatshme	50,731	43,001
<i>Shumat e mbajtura në BQK</i>		
Llogaritë rrjedhëse	20,203	18,192
Rezerva statutore	43,100	37,760
Gjendja me Bankën Qendrore të Republikës së Gjermanisë	149,075	59,022
Lejimi për rënie në vlerë	(33)	(30)
	263,076	157,945

Lëvizja e rënies në vlerë për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, ngarkuar në fitim dhe humbje është si më poshtë:

	2020	2019
Lejimi për humbje me 1 janar	30	35
Pasuritë e reja financiare të krijuara	-	-
Lirimi për shkak të shlyerjes	-	(35)
Transferet ndërmjet fazave	-	-
Rritja/Ulja e riskut të kredisë	3	30
Gjendja mbyllëse	33	30

Në përputhje me rregulloren e BQK-së për kërkesat minimale të rezervës, banka duhet të ruajë raportin minimal të rezervës së detyrueshme prej 10 për qind të detyrimeve në vijim me afat maturimi deri në një vit: depozita, huazime dhe letra me vlerë.

Pasuritë me të cilat banka mund t'i plotësojë kërkesat për rezervë janë depozitat e saj me BQK-në dhe pesëdhjetë për qind (50%) të parasë në kasafortat e saj. Megjithatë, depozitat në BQK nuk mund të jenë më pak se gjysma e rezervës së detyrueshme minimale të zbatueshme.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë paraqitur si më poshtë:

	2020	2019
Paraja e gatshme dhe balancat me Bankat Qendrore	263,076	157,945
Rezerva statutore	(43,100)	(37,760)
Kreditë dhe paradhëniet për banka me maturim fillestar prej 3 muaj ose më pak (shënim 12)	31,905	23,375
	251,882	143,560

12. Kreditë dhe paradhëniet për bankat

	2020	2019
Llogaritë rrjedhëse	23,286	13,136
Depozitat me afat me bankat	16,631	27,574
Lejimi për rënie në vlerë	(2)	-
	39,916	40,710

Lëvizja e rënies në vlerë për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, ngarkuar në Fitim dhe humbje është si më poshtë:

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

12. Kreditë dhe paradhëniet për bankat (vazhdim)

	2020	2019
Lejimi për humbje me 1 janar		2
Pasuritë e reja financiare të krijuara	2	-
Lirimi për shkak të shlyerjes	-	(2)
Transferet ndërmjet fazave	-	-
Rritja/Ulja e riskut të kredisë	-	0
Gjendja mbyllëse	2	0

Normat vjetore të interesit për depozitat me afat në banka në fund të periudhës raportuese ishin si më poshtë:

- Depozitat në EURO: prej -0.49% vjetore (2019: prej -0.60% deri -0.24 % vjetore); dhe
- Depozitat në USD: prej 0.16% deri 0.13% vjetore (2019: prej 1.53% deri 2.89% vjetore).

13. Kreditë dhe paradhëniet për klientët

	2020	2019
Kredi për klientët	507,626	490,731
Mbitërheqjet	27,362	31,915
Kartat e kreditit të arkëtueshme	89	109
	535,077	522,755
Lejimi për rënie në vlerë	(20,823)	(17,495)
	514,254	505,260

Lëvizja në kreditë ndaj klientëve dhe provizionin për rënien në vlerë të kredive për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019, bazuar në kërkesat e SNRF 9, është si më poshtë:

Vlera bartëse bruto	Gjendja më 1 janar 2020	Transferet	Rritja/Zvogëlimi (përfshirë shlyerjet)	Norma këmbimi dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2020
Faza 1 - Humbjet e pritshme 12 mujore të kredisë					
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	492,044	(19,425)	23,056	141	495,816
Faza 2 - Humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetëgjatësisë, pa rënie në vlerë					
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	15,595	11,099	(5,638)	(133)	20,923
Faza 3 - Humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetëgjatësisë, me rënie në vlerë					
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	15,116	8,326	(5,149)	45	18,338
Gjithsej	522,755	-	12,269	53	535,077

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

13. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Lejimet për rënie në vlerë	Gjendja më 1 janar 2020	Transferet	Rritja/ Zvogëlimi	Ndryshimi në parametrat e modelit të rrezikut	Normat e këmbimit dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2020
Faza 1 - Humbjet e pritshme 12 mujore të kredisë						
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	(5,409)	7	(1,880)	(80)	-	(7,362)
Faza 2 - Humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetëgjatësisë, pa rënie në vlerë						
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	(1,044)	603	513	(2,139)	-	(2,067)
Faza 3 - Humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetëgjatësisë, me rënie në vlerë						
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	(11,042)	(610)	(492)	336	414	(11,394)
Gjithsej	(17,495)	-	(1,859)	(1,883)	414	(20,823)

Vlera bartëse bruto	Gjendja më 1 janar 2019	Transferet	Rritja/Zvogëlimi (përfshirë shlyerjet)	Shkëmbime t e huaja dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2019
Faza 1 - Humbjet e pritshme 12 mujore të kredisë					
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	481,862	(11,131)		(139)	492,044
Faza 2 - Humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetëgjatësisë, pa rënie në vlerë					
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	17,482	7,471	(12,304)	2,946	15,595
Faza 3 - Humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetëgjatësisë, me rënie në vlerë					
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	19,244	3,660	(8,565)	777	15,116
Gjithsej	518,588	-	583	3,584	522,755

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

13. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Lejimet për rënie në vlerë	Gjendja më 1 janar 2019	Transferet	Rritja/ Zvogëlimi	Ndryshimi në parametrat e modelit të rrezikut	Normat e këmbimit dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2019
Shkalla 1 - Humbjet e pritshme 12 mujore të kredisë						
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	(8,559)	240	(2,092)	5,003	(1)	(5,409)
Shkalla 2 - Humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetëgjatësisë, pa rënie në vlerë						
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	(3,278)	452	533	1,269	(20)	(1,044)
Shkalla 3 - Humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetëgjatësisë, me rënie në vlerë						
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	(13,657)	(692)	1,461	2,058	(212)	(11,042)
Gjithsej	(25,494)	-	(98)	8,330	(233)	(17,495)

	2020			2019		
	Shuma bruto	Lejimi për rënie në vlerë	Shuma neto	Shuma bruto	Lejimi për rënie në vlerë	Shuma neto
Klientët me pakicë:						
Mbitërheqjet	1,254	(107)	1,147	2,312	(181)	2,131
Kartat e kreditit	10	(2)	8	21	(7)	14
Kreditë private	3,110	(729)	2,381	5,871	(2027)	3,844
Përmirësimet në shtëpi	88,472	(3,233)	85,239	95,711	(2,376)	93,335
Klientët e korporatave:						
Mbitërheqjet	26,108	(1,268)	24,840	29,603	(1,096)	28,507
Deri në 150 mijë Euro	152,012	(8,987)	143,025	96,161	(6,295)	89,866
Mbi 150 mijë Euro	264,111	(6,497)	257,614	293,076	(5,513)	287,563
	535,077	(20,823)	514,254	522,755	(17,495)	505,260

Lëvizjet në lejimet për rënie në vlerë më 31 dhjetor 2020 ishin si më poshtë:

	2020	2019
Në 1 janar	17,495	25,494
Ngarkesa për vitin	2,376	(8,453)
Lejimi i skontimit	(130)	(167)
Kreditë e shlyera	1,082	621
Në 31 dhjetor	20,823	17,495

Ngarkimi (shpenzimi) për vitin, e paraqitur në pasqyrën e fitimit ose humbjes përfshin shpenzimin e provizionit të humbjes së kredisë prej 12,016 mijë euro (2019: 11,730 mijë euro), të ardhurat nga kthimi i provizionit të humbjes së kredisë prej 5,508 mijë euro (2019: 20,183 mijë euro), 4,132 mijë euro është shuma e huave të rikuperuara të shlyera më parë (2019: 4,100 mijë euro) dhe 295 mijë euro shpenzime provizionit për zërat jashtë bilancor dhe aktivet e tjera financiare.

Më 31 dhjetor 2020, portfolio i kredive përfshinë kreditë për punonjësit e bankës në shumën prej 1,325 mijë euro (2019: 737 mijë euro). Këto kredi janë monitoruar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), që përcakton limite maksimale të lejuara për kredi të tilla në raport me kapitalin rregullator të bankës.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

14. Investime në letrat me vlerë të matura në VDPHTGJ

	2020	2019
Investime në letrat me vlerë të matura në VDPHTGJ	64,969	87,010
Lejimi për rënie në vlerë	(14)	(11)
Gjithsej	64,955	86,999

Lëvizja në rënien në vlerë për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, i ngarkuar në fitim dhe humbje është si vijon:

	2020	2019
Lejimi për humbje me 1 janar	11	21
Pasuritë e reja financiare të krijuara	8	-
Lirimi për shkak të shlyerjes	(2)	(18)
Transferet ndërmjet fazave		
Rritja/Ulja e riskut të kredisë	(3)	8
Gjendja mbyllëse	14	11

15. Pasuritë e paprekshme

	Softuerët
Kostoja	
Më 1 janar 2019	7,247
Shtesat	9
Shlyerjet	(1)
Më 31 dhjetor 2019	7,255
Shtesat	45
Shlyerjet	-
Më 31 dhjetor 2020	7,299
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2019	7,214
Ngarkesa për vitin	22
Shlyerjet	(1)
Më 31 dhjetor 2019	7,235
Ngarkesa për vitin	13
Shlyerjet	-
Më 31 dhjetor 2020	7,248
Vlera kontabël neto	
Më 31 dhjetor 2019	20
Më 31 dhjetor 2020	51

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

16. Prona dhe pajisjet

	Toka dhe ndërtesat	Biznesi dhe pajisjet e zyrës	Tokë dhe ndërtesa (E drejta e shfrytëzimit)	Gjithsej
në mijëra euro				
Kostot totale të blerjes më 1 janar 2020	8,620	9,793	2,542	20,955
Shtesat	1,578	3,018	22	4,618
Largimet	(56)	(1,572)	(25)	(1,653)
Transferet	(10)	10		-
Kostot totale të blerjes më 31 dhjetor 2020	10,131	11,249	2,539	23,919
Zhvlerësimi i akumuluar më 1 janar 2020	(1,575)	(8,625)	(401)	(10,601)
Zhvlerësimi	(179)	(798)	(423)	(1,400)
Largimet	36	1,445	17	1,498
Rënia në vlerë	-	(176)	-	(176)
Zhvlerësimi i akumuluar më 31 dhjetor 2020	(1,718)	(8,154)	(807)	(10,679)
Vlera neto kontabël	8,413	3,095	1,733	13,240

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

16. Prona dhe pajisjet (vazhdim)

	Toka dhe ndërtesat	Biznesi dhe pajisjet e zyrës	Tokë dhe ndërtesa (E drejta e shfrytëzimit)	Gjithsej
Në mijëra euro				
Kostot totale të blerjes më 1 janar 2019	14,708	10,098	-	24,806
Shtesat	779	457	2,542	3,778
Largimet	(6,867)	(760)	-	(7,628)
Kostot totale të blerjes më 31 dhjetor 2019	8,620	9,793	2,542	20,955
Zhvlerësimi i akumuluar më 1 janar 2019	(3,599)	(6,705)	-	(10,304)
Zhvlerësimi	(236)	(1,426)	(401)	(2,063)
Largimet	2,260	567	-	2,827
Rënia në vlerë	-	(1,062)	-	(1,062)
Zhvlerësimi i akumuluar më 31 dhjetor 2019	(1,575)	(8,625)	(401)	(10,601)
Vlera neto kontabël	7,045	1,168	2,141	10,354

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

17. Pasuritë tjera financiare

	2020	2019
Tarifat e përlllogaritura të mirëmbajtjes së llogarisë	288	335
Depozitat e letrave me vlerë	531	579
Të arkëtueshmet nga institucionet financiare	413	596
Të arkëtueshmet nga klientët (jo lidhur me huadhënien)	356	562
Pasuritë tjera	294	287
Lejimi për rënie në vlerë	(31)	(40)
	1,851	2,319

Lëvizja në provizion për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, i ngarkuar në fitim dhe humbje është si vijon:

	2020	2019
Lejimi për humbje me 1 janar	40	59
Pasuritë e reja financiare të krijuara	-	-
Lirimi për shkak të shlyerjes	(12)	(59)
Transferet ndërmjet fazave	-	-
Rritja/Ulja e riskut të kredisë	3	40
Gjendja Mbyllëse	31	40

18. Pasuritë tjera

	2020	2019
Shpenzimet e parapaguara	243	359
Llogaritë e kliringut në fund të vitit	448	362
Inventarët dhe paradhëniet	248	541
	939	1,262

19. Detyrimet ndaj bankave

	2020	2019
Llogaritë rrjedhëse	608	715
	608	715

20. Detyrimet ndaj klientëve

	2020	2019
Llogaritë rrjedhëse	484,388	421,451
Llogaritë e kursimeve	164,948	143,927
Depozitat me afat	96,220	103,837
Llogari të tjera të klientëve	4,242	3,898
	749,798	673,113

Balancat e detyrimeve ndaj klientëve (llogaritë rrjedhëse, të kursimet dhe depozitat me afat) përfshijnë shumën prej 4,378 mijë euro (2019: 6,525 mijë euro) që përfaqëson kolateralin në para të gatshme të marrur për kredi, garancione, letra të kreditit dhe urdhërpagesa në emër të klientëve.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumatat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

20 .Detyrimet ndaj klientëve (vazhdim)

Normat vjetore të interesit të publikuara më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 ishin si më poshtë:

	Klientë Privat		Klientë Biznesor	
	2020	2019	2020	2019
Llogaritë e kursimeve	0.30%	0.30%	0.30%	0.30%
Depozitat me afat:				
- Një vit	0.50%	0.50%	0.01%	0.01%
- Dy vite	0.70%	0.70%	0.01%	0.01%
- Tre vite	1.00%	1.00%	0.01%	0.01%
- Katër vite	n/a	n/a	0.50%	0.50%
- Pesë vite	n/a	n/a	1.50%	1.50%

Llogaritë rrjedhëse në përgjithësi nuk kanë interes. Llogaria e kursimit për klientët e biznesit mbart interes për bilancet mbi 30 mijë euro.

21. Detyrime tjera financiare

	2020	2019
Shpenzimet akruale	88	177
Të pagueshme ndaj furnitorëve	1,022	920
Detyrimet ndaj palëve të lidhura	101	302
Kontributi pensional i pagueshëm në Fondin Pensional të Kosovës	38	37
	1,249	1,436

22. Detyrime tjera

	2020	2019
Provizionet për pushimet e pashfrytëzuara	196	120
Provizionet për rastet gjyqësore	822	857
Provizionet për garancionet	738	453
Detyrimet e qirasë	1,815	2,184
Të tjera	1,111	1,205
	4,682	4,819

Lëvizja në detyrime të tjera paraqitet si më poshtë:

	2020	2019
Gjendja më 1 janar	4,819	2,285
Provizionet për pushimin e pashfrytëzuar, rastet ligjore, garancitë dhe të tjera	3,098	2,251
Detyrimet e qirasë	(369)	2,184
Lirimi i provizioneve	(2,866)	(1,901)
Gjendja mbyllëse më 31 dhjetor	4,682	4,819

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

23. Huamarrjet dhe borxhi i varur

	2020	2019
Fondet e huazuara nga Banka Evropiane e Investimeve (EIB) dhe EBRD	24,981	19,906
Borxhi i varur nga ProCredit Holding AG & CO.KGaA	7,537	7,538
	32,518	27,444

Përfshirë në depozitat me afat është gjithashtu interesi i përllogaritur i depozitave me afat dhe huave dhe borxheve të varura. Lëvizjet në interes të përllogaritur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë paraqitur më poshtë:

	2020	2019
Gjendja hapëse	917	582
Shpenzimet e interesit	2,349	1,957
Interesi i paguar	(2,156)	(1,622)
Gjendja mbyllëse	1,110	917

Bazuar në marrëveshjen me Bankën Evropiane të Investimeve (EIB) të nënshkruar në nëntor 2013, janë marrë 10,000 mijë euro (2019: 10,000 mijë euro) dhe sipas marrëveshjes, qëllimi i këtyre fondeve është financimi i projekteve që ndërmerren nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Bazuar në marrëveshjen me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) të nënshkruar në dhjetor 2018, 5,000 mijë euro (2019: 10,000 mijë euro) janë marrur gjatë vitit 2020, dhe sipas marrëveshjes, qëllimi i këtyre fondeve është financimi i projekteve është financiami sipas Programit për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme.

Borxhi i varur nga ProCredit Holding AG & CO.KGaA që bazohet në zgjatjen e nënshkruar në nëntor 2019, arrin në 7,537 mijë euro (2019: 7,538 mijë euro) në 31 dhjetor 2020, që përfshin kryegjënë dhe interesat e përllogaritura.

Në bazë të miratimit të dhënë nga Banka Qendrore e Kosovës, borxhi i varur është klasifikuar si kapital i klasës II dhe përfshihet në kapitalin rregullator të Bankës.

24. Kapitali aksionar dhe rezervat

Kapitali aksionar Më 31 dhjetor 2020 kapitali aksionar i autorizuar përbëhet nga 12,269,242 aksione të zakonshme (2019: 12,269,242), me një vlerë nominale prej 5 euro secili, ndërsa struktura aksionare ishte si më poshtë:

	Numri i aksioneve	Në Euro	%
ProCredit Holding	12,269,242	61,346,210	100
	12,269,242	61,346,210	100

Të gjitha aksionet e emetuara paguhen plotësisht. Nuk ka kufizime, kushte ose preferenca të lidhura me aksionet e zakonshme.

Primi i aksioneve Primi i aksioneve prej 4,204 mijë euro (2019: 4,204 mijë euro) përfaqëson tejkalimin e kontributit të marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara.

Rezerva kontingjente Rezerva kontingjente prej 511 mijë euro është krijuar në vitin 2000, nëpërmjet ndarjes së fitimeve të mbajtura. Rezerva përfaqëson një provizion kundrejt riskut politik dhe nuk mund të shpërndahet si dividendë pa miratimin paraprak nga BQK-ja.

Pas miratimit fillestar të SNRF 9 nga Banka Qendrore e Kosovës, që nga 1 Janari 2020, vlera prej 6,371 mijë euro është paraqitur për qëllime rregullatore si Rezervë tjetër. Kjo rezervë përfaqëson ndryshimin midis shifrave të raportuara të SNRF-së dhe shifrave të raportuara të BQK-së që nga 1 janari 2020, prandaj është një transferim nga fitimet e mbajtura në bilancin e rezervës tjetër dhe nuk shpërndahet për qëllime të dividendit.

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

24. Kapitali aksionar dhe rezervat (vazhdim)

Rezerva e vlerës së drejtë Rezerva e vlerës së drejtë përfshin ndryshimin neto kumulativ në vlerën e drejtë të investimeve në letra me vlerë të matura nëpërmjet VDPHTGJ, derisa investimi nuk çregjistrohet ose të njihet për rënie në vlerë. Lëvizjet në rezervën e vlerës së drejtë paraqiten si në vijim:

	2020	2019
Gjendja më 1 janar	141	49
Rezerva e humbjeve të rivlerësimit për investimet në VDPHTGJ	185	(35)
Rezerva e fitimit të rivlerësimit për investimet në VDPHTGJ	(263)	149
Tatimt e shtyra në rezervën e vlerës së drejtë në VDPHTGJ	8	(11)
Lejimi për rënie në vlerë	3	(11)
Gjendja më 31 dhjetor	74	141

Dividendët e paguar: Dividendët nuk janë shpërndarë në vitin 2020 (2019: 17,000 mijë euro ose 1,39 euro për aksion).

25. Transaksionet me palët e lidhura

ProCredit Group (“Grupi”) përbëhet nga banka komerciale të orientuara nga zhvillimi që veprojnë në Evropën Juglindore dhe Lindore dhe në Amerikën e Jugut, si dhe një bankë në Gjermani. Kompania amë e Grupit është ProCredit Holding, një njësi ekonomike me bazë në Frankfurt, e cila udhëheq Grupin. Grupi nuk ka një njësi kontrolluese përfundimtare. Në një nivel të konsoliduar, Grupi mbikëqyret nga Autoriteti Mbikëqyrës Gjerman (BaFin) dhe Banka Qendrore e Republikës së Gjermanisë. Grupi ProCredit synon të kombinojë ndikimin e lartë të zhvillimit me suksesin komercial për aksionarët e saj.

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj bankare, Banka ka hyrë në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura dhe balancat me aksionarët dhe subjektet e lidhur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si në vijim:

	Marrëdhënia	2020	2019
Pasuritë e arkëtueshme nga:			
Kreditë dhe paradhëniet për bankat e tjera ProCredit	Subjektet nën kontroll të përbashkët	3,220	3,793
Pasuritë financiare të arkëtueshme nga bankat e tjera ProCredit dhe Akademi		147	78
Pasuritë financiare të arkëtueshme nga Quipu GmbH		1	1
		3,368	3,872
Detyrimet ndaj:			
Detyrimet ndaj bankave të tjera ProCredit	Subjektet nën kontroll të përbashkët	247	491
Detyrimet financiare ndaj bankave të tjera ProCredit		51	57
Detyrimet financiare ndaj Quipu GmbH		237	349
Detyrimet ndaj Quipu GmbH		120	48
Detyrimet ndaj ProCredit Holding AG & Co. KGaA	Kompania amë	8,541	70
Borxhi i varur nga ProCredit Holding AG & Co. KGaA		7,537	7,538
		16,733	8,553

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

25. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2020, Banka kishte një marrëveshje për linjë kreditore me ProCredit Holding me një limit të pashfrytëzuar në dispozicion prej 15,000 mijë euro (2019: 15,000 mijë euro), me maturitet më 31 mars 2021 (data e maturimit automatikisht do të zgjatet me një vit) për qëllimet e plotësimit të nevojave të përgjithshme të financimit.

	Marrëdhënia	2020	2019
Të hyrat nga:			
Të hyrat nga interesi nga bankat ProCredit	Nën kontroll të përbashkët	3	26
Të hyrat tjera nga ProCredit Group		143	240
Të hyra tjera nga Quipo		9	-
		152	266
Shpenzimet:			
Kompania amë: Shpenzimet e interesit për borxhin e varur		344	487
Kompania amë: Shpenzime të tjera administrative		830	699
Kompania amë dhe akademitë: Shpenzimet e trajnimit	Kompania Amë	314	510
Kompania amë: Tarifet e zotimeve		666	730
Quipu GmbH: Shërbimet e IT-së	Nën kontroll të përbashkët	3,096	2,162
Quipu GmbH: Tarifet e përpunimit të kartelave		673	856
		5,923	5,444
Kompensimi i menaxhimentit kyç:		2020	2019
Pagat		195	176
Kontributet pensionale afatshkurtra (skema e detyrueshme)		10	9
Tatimi mbi të ardhurat personale		18	16
		223	201

26. Zotimet dhe kontingjencat

	2020	2019
Garancionet, letrat e kreditit dhe zotimet e kredisë		
Zotimet e kredisë (shih detajet më poshtë)	69,175	58,270
Garancionet ndërkombëtare	22,346	23,498
Garancionet lokale	11,692	12,790
Letrat e kreditit	76	213
Minus: Provizionet e njohura si detyrime	(738)	(453)
	102,551	94,318
Zotimet e kredisë		
Mjetet e pashfrytëzuara të kredit kartelave	1,506	1,547
Limitet e pashfrytëzuara të mbitërheqjes	37,330	30,406
Këstet e pa disbursuara të kredive	5,568	6,561
Pjesa e pashfrytëzuar e linjave kreditore	24,772	19,756
	69,175	58,270

Garancionet dhe letrat e kreditit të lëshuara në favor të klientëve sigurohen nga kolaterali në para të gatshme, pasuritë e paluajtshme dhe kundër garancionet e marra nga institucionet e tjera financiare.

Zotimet për të zgjeruar kredinë paraqesin zotime kontraktuale për dhënie të kredive dhe kredive qarkulluese. Zotimet në përgjithësi kanë datat fikse të skadimit ose klauzola tjera të ndërprerjes. Meqenëse zotimet mund të skadojnë pa u tërhequr, shumat totale nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht kërkesat për para.

Rastet ligjore Në rrjedhën normale të biznesit, Bankës i paraqiten kërkesa ligjore dhe kontestuese; menaxhmenti i Bankës është i mendimit se nuk do të lindin humbje materiale në lidhje me pretendimet ligjore të pazgjithshme më 31 dhjetor 2020, përveç atyre të parashikuara (Shënimi 22).

PROCREDIT BANK SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

27. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje tjera materiale që kanë ndodhur pas datës së raportimit e që kërkojnë shpalosje në pasqyra financiare.